

PROCESVERBALI

Nga mbledhja VI-të e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 26.04.2018, duke filluar nga ora 10:10, në sallën e Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm 39 anëtarë.

Të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, OSBE-ja, Zyra e EULEX-it, KFOR-it dhe përfaqësuesit e medimeve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Artan Abrashi, kryesues.

Për këtë mbledhje janë paraparë këto pika për:

R E N D D I T E

- 1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të datës: 1 mars dhe 15 mars 2018;**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës të propozuar;**
- 3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;**
- 4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, për vitin 2018;**
- 5. Shqyrtimi dhe miratimi i porpozimvendimit për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2016 dhe 2017, në vitin 2018;**
- 6. Shqyrtimi i Raportit të Realizimit të Buxhetit Komunal i vitit 2017;**
- 7. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për Transparencë në Komunë, për vitin 2018;**
- 8. Shqyrtimi i propozimvendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik.**

Pika e parë:

Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të datave: 01 dhe 15 mars 2018

Kryesuesi, e hapi debatin lidhur më procesverbalet, duke pyetur se a ka dikush për të shtuar diçka, e nëse jo e hedh në votim.

Atëherë, konstatojmë se unanimisht janë miratuar procesverbalet e mbledhjeve të kaluara.

Pika e dytë:

Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës të propozuar

Kryesuesi, a ka dikush të shtoi diçka për rënd dite të cilin e kemi paraparë në mbledhjen e fundit të KPF-së.

Illir Baldedaj (AAK): Kërkoj të di a ka qenë legjitime mbledhja e KPF-së. Sepse në asamblenë komunale kemi thënë që është udhëzimi administrativ, që kërkon 50-50%. Ndërsa në KPF unë pash 5 me 3. Sa është legjitim ky rend dite?

Shukri Quni (PDK): Konstatoj që ky komitet nuk është legjitim, sepse nuk janë votuar nga PDK-ja, anëtarët e KPF-së.

Kryesuesi: Një shpjegim të shkurtër. Siç e dini vendimi i Kuvendit, ka qenë dashur ta rishqyrtoj vendimin e mëparshëm lidhur me përbërjen e KPF-së. Ku sipas detyrimit që ka ardhur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, është dashur të vendoset kuota për pjesën e anëtarëve të cilët zgjidhen nga Kuvendi. Sipas udhëzimit administrativ, kryesuesi automatikisht është pjesë dhe drejton mbledhjet e komitetit. Kurse tetë të tjerët, që është numër qift, katër duhen të jenë femra dhe katër meshkuj. Deri më tani të gjitha subjektet politike i kanë dorëzua me shkrim, emrat e të propozuarve të tyre të KPF-së. Vetëm subjekti i AAK-së ende nuk e ka dorëzuar emrin për këtë komitet. Ne do të presim që ky emër të dorëzohet nëse ka vullnet. Nëse jo, padyshim që do të drejtohem ministrisë përkatëse që t'na njoftoj lidhur me atë se si mund të vazhdojmë më tutje.

Illir Baldedaj: Në vendimin e parë që e ka marr asambleja komunale, ne e kemi votua KPF-në dhe janë dhënë emra. Ndërsa në vendimin e dytë, keni kërkuar 50-50, dhe në mënyrë arbitrare, si kryesues i asamblesë komunale, i ke detyrua subjektet tjera politike, t'ia përcaktosh se a do të jetë i gjinisë femërore apo mashkullore. Edhe nëse ai vendim sipas teje ka qenë i rregullt, dje po të heqim ty me automatizëm si kryesues, ka qenë 4 me 3. Dhe përsëri unë nuk besoj që ka legjitimitet ky rend i ditës dhe KPF-ja, nëse flasim në atë ligjshmërinë që ti po thirrësh kryesues.

Shukri Quni: Ky komitet që nuk është votua nga anëtarët e PDK-së, a janë legjitim a jo? Këtu është puna. Ne nuk e kemi votua atë ditë. Këta janë anëtarë të PDK-së në KPF, të pa votuar. Kjo për mua është jo legjitime, sepse nuk e kamë ngritë dorën që të me përfaqësojnë në KPF. Nëse donë që këta me ia bërë vetin qejfin, ajo është diçka tjetër. Mirëpo nuk është votuar.

Kryesuesi: Formimi i komisioneve bëhet me shumicë votash të anëtarëve të Kuvendit, pa specifikua përkatësinë partiake. Rrjedhimisht edhe PDK-ja me shkresë zyrtare i ka dorëzuar të propozuarit e tyre, të nënshkruar nga personi i autorizuar. Rrjedhimisht sa i përket subjektit të juaj, ajo i ka më tashmë anëtarët, janë të përfaqësuar në KPF. Dhe se komiteti vazhdon punën deri në një vendim të ardhshëm të Ministrisë, nëse parasheh diçka tjetër. Sqaroi se jo vetëm për KPF-në, të gjitha komisionet, në rast se duhet ky Kuvend të plotësoj, ndryshoj, apo të shtoj, këtë punë e kemi për detyrë dhe do ta bëjmë pa hezitim. Atëherë e hedh në votim këtë rend dite, kush është për?

Për? – 31.

Kundër? – 1.

Abstenime? – 5.

Atëherë konstatoj se me 31 për, 1 kundër dhe 5 abstenime miratohet rendi i ditës.

Pika e tretë:

Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme.

Skender Sallauka (PDK): Qyteti ynë Prizreni, çdo ditë ka nevojë për energji pozitive, profesionalizëm dhe mirëqeverisje nga të gjithë ne. Pa dallime partiake politike, që me vullnet dhe përkushtim të bëjmë punë të mira. Në mënyrë që ta profesionalizojmë dhe postojmë duke e bërë shembull jo vetëm në Kosovë, por atë që i takon një qyteti historik në gjithë rajonin. Nga këndvështrimi im i analizimit të raportit njëqind ditor, të lëshuar nga Kryetari i komunës para dy ditësh. Në radhë të parë po ta shikosh këtë raport, nga volumi të mbushet mendja se vërtetë është punuar diçka këto njëqind ditësh. Ndërsa nëse ndalemi dhe e analizojmë këtë raport në përmbajtje. Në të gjitha fushat e cekuar nuk të krijon asnjë përshtypje, më së shumti, se sa vetëm takime, udhëtime, ligjërime, mendime teorike, vetëm letër. Pra, aq pak është punua, sa ka shumë për tu thënë lidhur me njëqind ditshin, e mos punës të kësaj qeverisje lokale. Unë do të ndalëm vetëm në disa sektor, pikërisht në ato fusha që edhe gjatë fushatës është shfrytëzuar nga kjo qeverisje me disa premtime konkrete. Në përgjithësi nuk është bërë dhe punuar asgjë në bazë të planifikimit. Keni premtuar që do të ketë transparencë të punës. Për çka edhe është kritikuar qeverisja e juaj lokale nga OJQ monitoruese për media, për mos transparencë. Keni thënë që do ti zvogëloni drejtoritë dhe do të bëni përmirësimin e kushteve apo infrastrukturës institucionale edukativo- arsimore. Por në drejtoritë vetëm që janë shtua edhe nga një zëvendësdrejtor. Gjithashtu në lagjet nga vijmë ne, ku janë banorët, keni

premtuar që do ta bëni lagjen në fjalë të quajtur “Gurishtë” nënë Super Viva, të trafa lartë. Atje 130 shtëpi janë të bllokuara dhe janë pa rrugë. Ata kalojnë me një pronë private, që e ka lëshuar dikush si lëmoshë. Ne të nderuar kolegë jemi të gjithë të votuar dhe kemi marr vota dhe jemi respektua nga ajo lagje. Ajo lagje ka nevojë për përkrahjen tonë. Shqetësimi im është se jemi në pranverë dhe duhet që në mënyrë urgjente të merren hapa procedurale tani, se unë po ju garantoj se ka me ju zënë edhe bora në bazë të procedurave qysh i dimë ne, dhe qysh është problemi në atë lagje. Vetëm një shembull po e marr, nëse vjen koha të vlerësimi i shpronësimit të Ministrisë së Financave, ajo merr kohë tre muaj. E në çoftë se ne vonohemi prapë për atë lagje dhe nuk e kemi një rrugëzgjdhje për ata, atëherë me procedura ligjore ne s’kemi me mund me krye punë për atë lagje që janë 130 shtëpi. Këtë shqetësim e ka ngritur edhe kolegja ima nga radhët e LDK-së në mbledhjen e kaluar, ku edhe nënshkrime pa pru këtu. Sinqerisht po ju them, ajo lagje është në gjendje të mjerueshme. Aty duhet me intervenua edhe për një kohë me paraparë më afatgjatë. Aty ka mundësi jo një rrugë të çelët, por tri-katër rrugë dhe të bëhet me sinjalizime me gjithë infrastrukturën që i takon. Gjithashtu problem është edhe lagjen “2 Korriku”, specifikisht të shkolla e re ku quhet. Është një problem që sa kohë, që shkolla është me një infrastrukturë të vjetruar. Nuk ka sinjalistikë rrugore ku fëmijët qarkullojnë. Para një kohe, nuk e di sa jeni në dijeni, po e kanë dhënë mediat, një fëmijë është shtyp në atë rrugë. Edhe ka vozitje me shpejtësi të tejkaluar. Ne si Kuvend, ose edhe ju si kryesues, si kryetar duhet të merrni iniciativë dhe institucionet që janë kompetente të kenë vëmendjen. Të bëjnë presion edhe të policia dhe të tjerët, që pak të sillën aty edhe ti kryejnë punët e tyre me ligj, që të ruajnë sigurinë e fëmijëve. Po ju them edhe një herë, para një jave është shtypë një fëmijë aty. Po janë shtypë edhe tjerë, më herët. Po aty ka nevojë për sinjalistikë, nuk ka asnjë shenjë që tregon që është shkollë, as për shpejtësi, as një pengesë që mundet me zvogëluar shpejtësinë. Tash janë shumë faktor që munden me parandalua të keqën aty. Me një aspekt ju kisha lut që këto dy pika për mua janë më emergjente edhe për këtë Kuvend komunal. Për këtë thash edhe njëherë jemi votua, për këtë, ata banorë na kanë respektua neve. Ata janë në gjendje të mjerueshme.

Alush Shala (PDK): Theksoi se sa i përket përgjigjeve që i kam marr nga drejtori, nuk jam i kënaqur. Nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, përgjigja më është kthyer pozitive, a realisht veprimet janë të ndryshme, apo të kundërta. Andaj, nëse dilni dhe e shikoni jashtë qendrës së Prizrenit, besoi që do të bindesh se gjendja është edhe më e keqe. Po ashtu edhe Drejtoria e Inspektoratit më ka dhënë një përgjigje. Por si duket ka kërkuar përkrahjen time që unë ti eliminoj këto probleme. Kur bëhet fjalë te Benafi, makinat që janë në secilën

hyrje të qytetit të Prizrenit, Nëse nuk besoni qoni kënd të doni ju bën një fotografi, e keni te pompa e benzinës këtu në hyrje të qytetit. Dy makina që rrinë afër një vit. Qysh edhe në mandatin tonë. Andaj, nëse presim derisa të formohet një komision, edhe aty ku dihet që është pronë e komunës. Besoj që nuk duhet ndonjë koment. Sa i përket edhe përgjigjes të Drejtorit të Bujqësisë, që ka qenë problemi i qenve endacak. Është mirë të merren masa sa më shpejt, sepse singerisht, mund ti hasesh vetëm me një lëvizje shumë të vogël, ata do të jenë problem për shëndetin të fëmijëve, por edhe për qytetarët të komunës sonë. Po ashtu kam kërkuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, që të del në Ortakoll, ku është Inex pompa e benzinës, ta shikon mundësinë e hapjes të rreth rrotullimit dhe një vend parkim për autobusë. Sepse duke filluar thuaja prej pompës së benzinës petroll Spahi deri të rruga që kthen për Nashec, asnjë vend nuk ka parking të autobusit. Realisht aty është një rrezik potencial, jo vetëm për të rriturit, po për fëmijët në mënyrë më të veçantë. Banorët e atij lokaliteti do të bëjnë edhe një kërkesë, ku do t'ju dërgohet zyrtarisht. Gjithashtu kam kërkuar që të futet në rend dite edhe çështja e teleferikut. Por kuptohet që jam mbivotua edhe nuk kemi mund me shti në rend të ditës. Por unë do t'ia bëjë një pyetje kryetarit. Unë e kuptoj mundësinë dhe fuqinë tuaj ligjore. Ju mund të anuloni një tender, nëse ju vërtetë shihni që ka shkelje. Po të anulohet një vendim i Kuvendit, pa pëlqimin e kuvendarëve të rinj, më duket vërtet shumë absurde dhe më duket që është pronë e familjes suaj. Andaj, ju bëjë ftesë edhe njëherë ta korrigjoni vendimin tuaj. Nëse ka nevojë mu anulua, ne mund ta marrim edhe një vendim këtu. Nuk e di pse duhet të bëni shkelje shumë të panevojshme. I nderuari kryetar, ju keni bërë disa vizita jashtë Kosovës, me një ekip jashtëzakonisht të madh. Nuk e di se çfarë përfitojnë banorët e komunës sonë, me këto vizitat tuaja, me vizita të paparalajmëruara. Unë e di që ju ndoshta nuk keni nevojë me dhënë llogari. Por buxheti i komunës së Prizrenit, votohet nga këta kuvendarë. Andaj, kisha dashtë këtu ju publikisht të na tregoni për vizitat. Ju pos kuvendarëve që keni marrë me veti, keni pas edhe anëtarë të familjes suaj. Po ashtu kërkoi nga kryetari që ti vazhdohet projekti i Karitasit gjerman, sepse janë në pyetje 78 punëtor. Ky projekte nuk është i vetmi në Prizren, por është në 12 komunitat e Kosovës, ku ka vazhduar projekt. Në Ferizaj janë 170 punëtorë, ku po rishikohet mundësia e zvogëlimit të numrit të punëtorëve, mirëpo ai projekte do të vazhdoi. Pra, mbetet vetëm komuna e Prizrenit që po e ndërprejnë këtë projekte, sa i nevojshëm aq edhe human. Andaj, mua më duket që është gabim i juaj kryetar, sepse ju nuk doni të bisedoni me ministritë përkatëse. Ndoshta se s'janë të partisë suaj. Po këtu është në pyetje mirëqenia dhe mundësia e punësimit, apo e vazhdimit të punës të 78 të punësuarve. Kisha kërkuar nga ju ta rishikoni këtë mundësi. Po që se keni nevojë për ndihmën tonë. Unë po ju them edhe si anëtar i Kuvendit të komunës së Prizrenit, nga

radhët e PDK-së, aty ku ka qasje, ta marrim Ministrinë e Shëndetësisë, ju do ta keni përkrahjen për këtë projekt. Dhe realisht këtij projekti do ti ri-gëzohen edhe njëherë 78 familje të komunës sonë.

Fatmir Kastrati (AAK): Unë do ta ri përsërisë një pyetje që po e bëjë në këtë Kuvend nga viti 2007 e këndej. Pyes Drejtorin e Shërbimeve Publike, lidhur me çështjen e ujit të pijes, në lagjet “2 Korriku”, “11 Marsi” dhe “Dardania”. Sa qeveri vinë e shkojnë që nga LDK-ja, PDK-ja dhe partive tjera dhe çështja e ujit të pijes nuk e rregulluan në këto dy lagje. Ka shumë pyetje që bëhen këtu nga kuvendarët, që janë të rëndësishme. Po ma merr mendja se sa çështja e ujit të pijes nuk ka për momentin. Edhe 20000 banorë ti vuajnë pasojat e një neglizhence të qeverive të cilat janë të zgjedhura nga vetë ata, kjo po më duket që nuk është e drejtë edhe nuk është normale. Unë e di që në vitin e kaluar diku në shtator apo në gusht kanë filluar punimet në rregullimin e ujësjellësit, ose shtimit të kapaciteteve të ujit. Edhe e pyes Drejtorin e Shërbimeve Publike, deri ku kanë shkuar ato punime. A do të rregullohet ndonjëherë kjo çështje. Edhe në qoftë se jo, çka duhet të bëjmë ne qytetarët që 20 vite janë duke i vuajtur këto pasoja. Tash po fillon koha verore, po fillon të nxehti, edhe jo prej orës 8-15, po nuk do të kemi ujë as 24 orë. Prandaj një çështje urgjente që duhet kryetari i komunës të merret. Edhe në njëfarë mënyre, ne vazhdimisht po bëjmë ndaj të tjerëve. Po kur e kemi rastin me i krye do punë të cilat neve na takojnë atëherë të ulemi edhe ti kryejmë ato punë. Qytetarët jua kanë dhënë votën me shpresë që do të ketë ndryshime pozitive. Mirëpo, në këto 5-6 muaj nuk po shohë që ka ndonjë ndryshim pozitiv në qytetin e Prizrenit. Përveç disa projekteve elektronike ose në media që po i bëni. Unë nuk po e shoh ndonjë gjë konkrete në Prizren. E dyta e përsërisë pyetjen që e bëri edhe këshilltari Shala. Çka pret diçka konkrete qytetari i Prizrenit nga këto vizita, që kryetari i komunës me një staf të vetin po i bëjnë jashtë vendit. Edhe në Gjermani edhe në Turqi edhe kudo qoftë ku tjetër që kanë shkua. Këto vizita nuk duhet të jenë turistike, po vizita që sjellin diçka pozitive për qytetin e Prizrenit. Prandaj është mirë që të na jepen përgjigje me shkrim. Edhe ajo çka është konkrete, që ti gëzojmë qytetarët. Se vërtetë presin nga ne që të ketë diçka të mirë për qytetin. Edhe njëherë po i kthehem çështjes së ujit të pijes. Unë kërkoj një përgjigje shumë serioze nga Drejtori i Shërbimeve Publike, qoftë sot, qoftë në mbledhjen e ardhshme edhe atë me shkrim. Se kur do të zgjidhet ky problem.

Nazife Kokollari (LVV): Sot dua të ngrejë një çështje shumë të rëndësishme, të ndjeshme dhe të pa trajtuar më parë. Sot dua të flas për fëmijët me autizëm për të cilën asnjëherë nuk i është kushtuar vëmendje e duhur dhe e nevojshme. Kjo kategori e ndjeshme e shoqërisë tonë, që është realisht prezent, ka shumë nevojë që ne ti kthejmë pak sytë kah ata. Ata kanë nevojë të cilat ne

nuk i njohim dhe ndonjëherë duket se janë të harruar si shumë kategori tjera të shoqërisë sonë. Në këto kushte e shoh të nevojshme që të paktën ne si komunë, të bëjmë një numërim të rasteve me këto çrregullime. Të hulumtojmë më shumë për nevojat e këtyre fëmijëve, që janë të shumtë. Dhe duke mos përjashtuar diçka shumë të rëndësishme nevojat e familjarëve të tyre. Këta individ përballën me vështirësi të ndryshme në të gjitha fushat jetësore. E sikur të mos mjaftonte kjo, kam përshtypje që ne si shoqëri, nuk e kemi kaluar akoma sfidën e pranimit për këta njerëz, të cilët ne vetë i gjykojmë ndryshe. Krahas hulumtimi të numrit dhe të nevojave që kanë kjo kategori, e shoh të arsyeshme edhe nisjen e një fushate, e cila do të na ndihmonte të gjithëve për ti kuptuar dhe njohur më mirë. Dhe mbi të gjitha për ti pranuar si pjesë e shoqërisë sonë. Duhet të punojmë më shumë dhe ti mbështesim me organizime të ndryshme, që kjo kategori të ketë mundësi zhvillimi dhe përparimi. Krahas ndihmave konkrete që i përmenda që janë shumë të nevojshme, kjo kategori ka nevojë edhe për mbështetjen tonë morale dhe prezencën tonë reale në rrethin e tyre. Duke qenë se jemi në muajin e autizmit, ju ftoj të gjithëve që së bashku të ideojmë dhe hartojmë projekte, të cilat i ndihmojnë kësaj kategorie. Gjithashtu ndihmojnë edhe në përmirësimin e cilësisë së jetesës. Mbi të gjitha grupet e shoqërisë pa përjashtim. Sepse qyteti i Prizrenit, qytet i kulturës ka vend dhe mbështetje për të gjithë.

Antigona Bytyqi (PDK): Pasi që pika e tretë e rendit të ditës, na jep mundësi të bëjmë pyetje, unë kam pyetje për kryetarin. Si ne të gjithë kuvendarët po ashtu edhe ju kryetar, e dini shumë mirë që ne jemi të zgjedhur nga vota e qytetarëve të komunës sonë. E që funksionin tonë që ta ushtrojmë ashtu si duhet, ne duhet të jemi edhe llogaridhënës të denjë para atyre qytetarëve që na e besuan votën. Ne këtë gjë nuk po e shohim te ju. Prandaj pyetja ime për ju është: Pse mbledhjet që i mbani ju si kryetar me drejtorët komunal, janë të mbyllura për media dhe publikun. Dhe ku mbeti premtimi i juaj për transparencë.

Sulltan Badallaj (PDK): Unë do ti ngrejë tri çështje që janë të rëndësishme, që vazhdimisht ju na keni akuzuar kur kemi qenë ne në qeveri. Si pikë e parë është çështja e rrugës “Jeni Mëhalla” që dihet se 100% është investim i Ministrisë së Infrastrukturës. Z. Kryetar sapo keni ardhur në pushtet keni deklaruar që për dy javë do të kryhet ky projekt. U bënë tre muaj, ende nuk është krye. Gjithashtu në ditët e fundit disa qytetarë kanë bërë një kërkesë tek ju për mungesën e trotuarit, mungesën e auto parkingjeve në atë rrugë. Mirëpo duhet të dihet diçka se projekti është bërë në kushte që janë konkrete për atë vend. Dhe rruga nuk mund të zgjerohet kur të donë dikush, ose pavarësisht formave të ndryshme që janë ndërmarrë. Prandaj derisa njerëzit banojnë aty, i kanë shtëpitë e veta, ata duhet vetë ta sigurojnë parkingun e vetë për veturat e

veta. Se ne i dimë secila shtëpi aty e ka dyqanin e vetë. Mirëpo, kur e ka shtëpinë, ai duhet edhe me siguria parkingun për makinën e vetë, se jeton në qendër të qytetit. Po ashtu dua ta preki edhe një çështje shumë të rëndësishme që është debatua në lidhje me Shtëpinë e Kulturës në Zhur. Megjithëse është debatua disa herë, por prapë vlen të theksohet se vonesa e shtëpisë së kulturës në Zhur ka ndodh me problemin e juaj, që lëndën e keni qua në prokurori. Që pa asnjë shkak, pa asnjë arsye është vonua gati dy vite, kjo lëndë vetëm për arsye shumë të ulëta. Po ashtu keni thënë që nëse vijmë në pushtet edhe do ta prishim komplet shtëpinë e kulturës. Shtëpia e kulturës mundeni edhe me prish, rregullona të re, shumë në rregulle është kjo punë. Dua të ndalëm pak edhe te pastrimi i mbeturinave. Keni deklarua para disa ditëve z. Kryetarë që janë pastrua 400 tonë mbeturina, të ngurta. Ju lutemi kur i keni pastrua, a bënë me tregua ku i keni gjuajtur ato mbetje. Të kemi parë po ashtu me varkë në liqenin e Vërmicës, duke reklamuar gjëja pastrimin e tij. Dihet se komuna e Prizrenit asnjëherë nuk është marr me liqenin. Pastrimin e liqenit e ka bërë OJQ Finq me student të fakultetit të shkencave të natyrës. Bile as mjete të transportit nuk keni ofrua. Kanë qenë nëse s'gaboj nga Podujeva, do mjete kështu me ngjyra portokalli. Kush po ti servon këto informata nuk e dimë z. Kryetar. Por nuk mund ti hidhni pluhur qytetarëve të Prizrenit me paraqitje dhe promovime të pasakta. Prandaj duhet të ecni për toke z. Kryetar.

Ilir Gashi (LVV): Pyetja ime ka të bëjë me Drejtorinë e Komunale të Arsimit. Si qëndron çështja që jetojnë në lagjet periferike. Është rasti konkret lagjja “Baruthane”, ku nxënësit duhet të ecin diku rreth 25 minuta deri në shkollën fillore “Abdyl Frashri” në Ortakoll. Duke pasur parasysh edhe barrën, çantën me libra, fletorët që i kanë, si edhe kushtet atmosferike, verë, dimër, shi, borë, ftohtë e nxehtë. Gjithashtu kërkoi që eshtrat e Ymer Prizrenit që janë në Bashkësinë Islame të Prizrenit. Të bëhet rivarrimi në oborrin e Xhamisë së Bajraklis, aty edhe ku është mbajtur Kuvendi i Lidhjes së Prizrenit. Pasi që është një përvjetori jubilar dhe eshtrat qëndrojnë disa vite ende ashtu të hapura, pa u rivarrosur.

Petrit Hoxhaj (LDK): Pothuajse çdo ditë në sheshin e qytetit të Prizrenit, jemi duke parë disa organizata të ndryshme, që me gjasa nuk janë të këtij qyteti. Këto organizata përmes disa vajzave, janë duke kërkuar lëmosh për të sëmurit ose për fëmijët jetim. Më të vërtetë është bërë shumë e bezdisshme pothuajse çdo 5 metra të dalin vajzat, me ato pyetjet e zakonshme, më falni a keni kohë një minutë. Kërkoj të di se a kanë leje të veprimtimit këta persona në fjalë. Jam shumë i bindur se me këtë formë po plaçkiten qytetarët e Prizrenit, nga bosa të ndryshëm që po i përdorin këto vajza. Jam bazuar në disa raste se është plaçkitje në një qytet tjetër ku disa persona të tillë janë shoqëruar në

polici, dhe iu është ndaluar ushtrimi i kësaj veprimtarie. Jo vetëm kjo, por edhe mënyra e kontrabandat me qenie njerëzore, ku në këtë rast janë fëmijët dhe gratë e moshuara, komuniteti romë, ashkali dhe egjiptas. Të cilët janë viktimë e bosave të krimit, që nëpërmjet këtyre fëmijëve ja arrin qëllimin e tyre që të pasurohen. Qyteti është mbushur me fëmijë lypsar, të cilët ata duhet të jenë shkolla apo edhe në çerdhe. Ndërsa janë në rrugët e Prizrenit, në shi, diell, borë, në shërbim të bosëve. Kërkoj nga kryetari, dhe nga komisioni për siguri që të marrin masa sa më shpejtë dhe serioze. Sepse këta fëmijë janë bërë edhe të dhunshëm, duke ngacmuar gjininë femërore. Turistët që po vinë në këtë qytet. Dhe duke shitur substanca narkotike, e që besa Shatërvani është bërë një cirk lojërash për ta. Si kuvendarë i këtij qyteti, me javë të tëra kam hulumtua se kush fshihet mbrapa tyre, dhe kam identifikuar disa lokacione se ku po banojnë këta. Por ajo që më shumti më ka habitur, se as vetë këta nuk e dinë se për kënd janë duke punuar. Që OJQ-të që i kanë dërguar nuk e dinë se çfarë statusi kanë. Prandaj kërkoj që t'ju ndalohet çdo OJQ-së, që në mënyrë ilegale, pa pëlqimin dhe miratimin e komunës për të drejtën e lypjes nëpër shesh. Sepse nëse ju japim leje, atëherë ne do ti verifikojmë se kush janë, nga janë dhe për kënd janë duke ndihmuar. Ndërsa pyetja tjetër ka të bëjë për drejtorin Levent Kasami, në lidhje me çështjen e ujit të pijes në fshatin Vlashnje. Kuvendarja Ganimete Hoxha Banuna, pothuaj se katër vjet rresht ka kërkuar që të rregullohet kjo çështje e ujit. Unë kam një pyetje konkrete, se kur do të finalizohet, ose kur do të kenë qytetarët e fshatrave Kobajë, Vlashnje ujë të pijes. Sepse ne jemi duke kërkuar elementin bazë të jetës dhe nuk jemi duke kërkuar luks për diçka. Neve është na kushton, sepse çdo shtëpi pothuaj se ka humbje prej 2000 – 4000 € shpenzim për të hapur një pus. Ku e dimë që në fshatin Vlashnje shumë shpejt edhe do të ndërtohet impianti, dhe ujërat e puseve do të jenë jo funksionale. Ndërsa tjetra është se nga zyra e kryetarit më erdhe një vendim ose një përgjigje me shkrim. Por kisha pas dëshirë që gabimet drejtshkrimore mi rregullua. Se ka të bëjë me gjininë femërore këtu, a në fakt është bërë e gjinisë mashkullore.

Mimoza Bushrani (LVV): Vendimi për ndalimin e shitjes së shpezëve në hapësirat përball Qendrës sportive, ku edhe aty bëhet tregu të mërkurave nga Drejtoria e Inspektoratit, është mirëpritur nga ana e qytetareve në Bazhdarhane. Në këtë rastë kërkoi, po në këtë pjesë, por edhe ku nuk ka kushte minimale të ndalohet shitja e produkteve të ushqimit, nga ana e fermerëve individual. Paramendoni rrëmujën tash në mbarim të vitit shkollor, po edhe fluksi i madh nga mbarë Kosova që vinë për ta vizituar Prizrenin. Edhe një çështje tjetër mjaft brengosëse, janë sjelljet divijante të disa fëmijëve dhe adoleshentëve para shkollave. Kur kësaj ia shtojmë edhe faktin se pronarët e disa kiosqeve në afërsi të disa shkollave të mesme por edhe fillore, nxënësve po ju shitën cigare me

copë vlera e të cilët është 10 cent. Krijohet ambient optimal për tu rritur kjo dukuri tek brezat e ardhshëm. 10 cent është e mjaftueshme që një nxënës të jetë i prirur dhe të ketë mundësi të ketë dy-tri cigare në ditë, dhe prindërit të mos jenë fare në ngjarje me veset e fëmijëve të tyre. Prandaj kisha apeluar që Drejtoria e Inspektorateve, të ndërmarr masa rigorozë ndaj të gjithë atyre pronarëve të kiosqeve, që u shesin fëmijëve cigare me copë. Që fëmijët tanë ti kemi larg burimit të këqijave. Të jetosh me aftësi të kufizuar është sfidë. Vështirësitë shtohen kur në shoqëri ndjehesh i diskriminuar, qoftë në arsimim, punësim, apo edhe në lëvizje të lirë, si mungesë e infrastrukturës së duhur. Në emër të personave me aftësi të kufizuar, po ju drejtohem juve institucioneve komunale më qëllim të adresimit dhe shqetësimit të këtyre personave. Fjala është që të stimulohet punësimi i prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuar. Përkrahja e ndërmarrjeve sociale që merren me aftësinë e kufizuar intelektuale. Sigurimi i lokaleve për punën e OJQ-ve që punojnë me personat me aftësi të kufizuar. Komuna të kontaktoj shërbimet e OJQ-ve të licencuara për ofrim të shërbimeve. Trajnimi i stafit të mjekësisë familjar, për punë me persona me aftësi të kufizuar. Garantimi i poentave shtesë në rast të dhënies së grandeve për vetëpunësim dhe angazhim të personave me aftësi të kufizuar. Organizimi i fushatave vetëdijesuese për pranimin e personave me aftësi të kufizuar dhe evidentimi i stigmatizmit në shoqëri. Adaptimi i trotuareve për lëvizje me karrocë në tërë qytetin. Sigurimi i qasjeve nëpër objekte publike për përdoruesit e karrocave. Ndërtimi i tualeteve publike ku personat me aftësi të kufizuar kanë qasje me kartelë. Rritja e vetëdijes të popullatës për mos shfrytëzim të parkingjeve dhe tualeteve të dedikuara për personat me aftësi të kufizuar. Të futet gjuha e shenjave në faqen e internetit të komunës. Sigurimi i mësimdhënësit të stafit mbështetës ose asistentit të klasës. Instruktorit të gjuhës së shenjave për fëmijët me nevoja të veçanta në arsim. Në bazë të planit individual të arsimit. Sigurimi i transportit për shkollim të lartë të mesëm të fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim. Lirimi i personave me aftësi të kufizuar dhe shoqëruesit nga tarifat e transportit publik përfshirë edhe operatorët privat. Lirimi i personave me aftësi të kufizuar nga shërbimet komunale. Sigurimi i parkingjeve për personat me aftësi të kufizuar. Të rinovohen hapësirat ekzistuese që përdorën për organizatat që punojnë me persona me aftësi të kufizuar. Të sigurohen hapësira për qëndrim ditor për persona me aftësi të kufizuar. Të mundësohet liria e lëvizjes për persona me aftësi të kufizuar, pjerrina, gilinderat në shkallë. Lirimi i personave me aftësi të kufizuar nga tarifat komunale për regjistrim të makinës. Shpresoj ti kushtoni vëmendje këtyre kërkesave të adresuara.

Simir Krasniqi (PDK): Parashtroi pyetje për kryetarin e Komunës. Sipas ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kryetari komunës nuk ka këshilltarë. Kurse në kabinetin tuaj keni emëruar jashtëligjshëm zyrtarë të cilët në përkrahje quhen këshilltarë. Në bazë të cilit ligj keni vendosur për këta këshilltarë? Pyetja e dytë, po ashtu për kryetarin e komunës. Ju Mytaher Haskuka, si kryetar komune në 100 ditshin e juaj, si komunë e hapur, keni thënë që keni pasur 2313 takime me qytetarë, që nuk është aspak e vërtetë. Qytetarët e komunës së Prizrenit, çdo ditë e më shumë janë të dëshpëruar nga keqqeverisja e juaj. Presin që dy muaj për tu takuar me ju, për brengat e hallet që kanë. Nuk ju jepni mundësinë që të takoheni me ta, me arsyetimin që keni obligime dhe punë tjera. Pyetja ime është kjo, kur do ta prishni rrethojën e shtëpisë së bardhë. Kur PDK-ja qenë në pushtete, partia e juaj LVV-je ka protestuar disa herë për prishjen e rrethojës së shtëpisë së bardhë. Tash jeni në pushtet, nuk keni nevojë me protestuar, e keni fuqinë, i keni kompetencat. Hapuni për qytetarët dhe lironi shtëpinë e bardhë nga muri rrethues. Po ashtu pyetja e tretë për kryetarin e komunës. Mytaher Haskuka në deklaratimet e tij publike ke prezantuar një numër astronomik të padive civile, që ka komuna në institucionet gjyqësore. Si dhe vlera marramendëse të borxhit publik, nga kjo padi. Dhe se të gjitha nga këto padi janë ngritur në kohën e qeverisjes së PDK-së. Ju pyes në sa padi komuna e Prizrenit është palë e paditur, dhe në sa padi është palë paditëse. Në sa padi është palë ndërhyrëse. Prej cilit vit figurojnë këto padi. Dhe pyes sa padi janë ngritur që nga ardhja e juaj në këtë pozitë. E pyes Kryetarin Mytaher Haskuka, se komunën e Prizrenit kush po qeverisë? Ju si kryetar i komunës, apo ata që vinë nga Prishtina, ku po ju kontrollojnë dhe po kërkojnë llogari drejtorëve të komunës.

Ganimete Hoxha Babuna (Nisma): Parashtroi pyetje për kryetarin e Komunës, se cili është plani i juaj në lidhje me pronën publike. Kërkoj që rreth kësaj çështje të na sillni një raport me shkrim në Kuvend. Të njoftohen kuvendarët por edhe opinioni i gjerë, me të gjitha pronat komunale dhe mënyrën e shfrytëzimit në të kaluarën por edhe tani. Theksoi se në mandatin e kaluar e kam ngritur këtë shqetësim për shfrytëzimin e pronës komunale, nga klientelist të pushtetit të kaluar, ku asnjëherë s'ju kanë përgjigjur detyrimeve ndaj komunës.

Vjollca Kabashi (AAK): Parashtroi pyetje për drejtoreshën e Shëndetësisë, se a ka mundësi të punësohet edhe një radiolog apo radiologe e mamografisë. Të vazhdohet orari deri në ora 17 apo 18. Duke e parë një numër mjaftë të madhe të rrezikuar nga sëmundja e kancerit, ku për një mamografi duhet të presin për 5-6 muaj. Si ta ndërpresim sëmundjen në fazën e parë, kur shkojnë muaj të tërë duke pritur. Po ashtu dy dhoma specialiste të fëmijëve në

qendrën e stomatologjisë nuk janë të pajisura me mjete, kur buxheti ndahet çdo vit. Ndërsa në konkursin e fundit të punësimit të mjekëve në QKMF dhe AMF, kemi informacione që teksti i është dhënë kandidatëve tuaj të preferuar. Dhe me çfarë të drejte merr pjesë drejtoresha në test, gjatë testimit të kandidatëve.

Rreze Hoxha (PDK): Unë kam një pyetje për kryetarin e komunës. Sa punëtorë keni angazhuar me kontratë mbi vepër dhe a janë respektuar procedurat e konkursit?

Memnuna Ajdini (Vakat): Moje pitanje se odnosi za Direktorijajt za Javne Usluge i Direktorijajt za Bezbednost. Magistralni put na relaciji Prizren-Re ane, ima dosta odrona. Te tražimo od nadležnih organa koji su odgovorni za iš enje ovog puta, da iza u da iste stene koje su pala kao i zemlju. Tako e putevi za Župu i Podgor, trebaju da o iste od odrona, kamena i rastinja. Da bi preglednost za saobra aj bila bezbedna. Drugo pitanje je tekni ke prirode i odnosi se, to jest tražim da se aparati ovde u Skupštini za prevod da se zamene. Obzirom da ne rade ili uopšte ne ili vrlo slabo rade. Te je da je neophodno da imamo aparate koje e raditi. I samim tim da mi imamo kvalitetan prevod.

Azem Durmiši (NDS): Dosadašnji rad vlade skupštine, smatramo da je više teoretski nego prakti ni. Me utim slažemo za po etak da zaista treba problema postaviti na papiru. A naravno zahtevamo da problemi i da se realizuju u prksi po prioritetima. Upu ujem apel iz dosadašnjeg izlaganja kolega. Nemam protiv ništa ure ivanja samoga grada, zaista je potrebno to. Ali da se osvrnem i na ruralne sredine, odnosno seoske sredine. Koje smatrami mislim da ve ina nas poti e iz seoskih sredina. Da se susre emo sa ogromnim izlivom stanovništva iz sela ka gradu. Pa bi trebalo da imamo na umu malo ve i prioritet da se osvrnemo radom na seoske sredine i udovaljavanje što se ti e najosnovnijih ulova za života na selu. A i pre svega ja bi jednu paralelu izveo, ako nemamo sirovine, ne emo ni imati proizvode. Prema tome svim direktorima upu ujem da se malo osvrnu na seoske sredine. I pre nekoliko predhodnih seanci postavio sam pitanje za ure ivanje i pro iš avanje javnih saobra ajnica prema Župi za obelažavanje. Jer znamo pred nas koji period dolazi, gde slobodno možemo dakažemo ne samo u regionu Priziren. Nego i u celoj našoj Republici Kosovo da oko 50% našeg stanovništva je u diaspori. I da period koji nam dolazi, da ipak trebamo do ekati spremno, i zadovoljimo našim gra anma koji dolaze na odmor. A znamo kako dolaze. Ipak traba imati u vidu da oni ne dolaze praznih epova koji od velikog zna aja imamo koristi od njih. Zna i još jednom bi uputio pitanje da li može da se regionalnih putevi prema Župi urede kako dolikuje. I da se po selima predlažem jedna komisija da izlaze na uvid na licu mesta. I tako e što ho u da nadovežem da predhodnih kolega za zaštitu

dece od saobra ajnih nesre a da se postave uli ne prepreke za nesavesne voza e. Jer zaista sada period prole e, deca su nam na ulici. I trebamo ih zastiti na vreme. Ne da kasnije ih izloziamo u tim opasnostima da stradaju. Javno bi pozvao gradona elnika, predstavajaju eg, direktore i sve naše odbornike ovde skupštine. U subotu povodom našeg tradicionalnih susreta bošnjaka, da prisustvujete skupu na mesto zvano Leskoaren, na relaciji Re ane-Manistirica. U cilju druženja, rasonode i o uvanje našeg identiteta bošnjaka na ovim prosotrma na kojih žive u opštini Prizren.

Pranverim Berisha (Nisma): Dua të flas në lidhje me sektorin e zjarrfikësve në Prizren, një sektor shumë i rëndësishëm për punën që e bëjnë punëtorët e zjarrfikësve në të cilën kam kuptuar që aty ka nevojë për ndërhyrje me qëllim të përmirësimit të gjendjes së tanishme. Objektet të cilat ekzistojnë por që nuk janë funksionale, në duhet që të mundohemi që ti funksionalizojmë ,duke e përmirësuar gjendjen e tyre dhe se jam i mendimit që aty nuk ka nevojë të dërgojmë punëtor sezonal, por që aty duhet të ketë punëtor të rregullt, pra duhet të shtohet numri i punëtorëve. Sepse me shtimin e kapaciteteve të fuqisë punëtore, ne në fakt lehtësojmë edhe atë pjesë siç janë edhe objektet në Zhur, në Gjonaj dhe Reçane. Problemi i zjarrfikësve në Prizren ekziston që nga viti 2000 e deri më sot. Zgjdhja e vetme është që aty të shikojmë mundësinë, që çdo herë intervenimet të jenë më të shpejta dhe rreziqet të jenë më minimale. Çështja tjetër, që dua të ndërlidhem me problemet e trashëguara pikërisht nga problemi i qeverisjes së kaluar, është fjala për Stacionin e Autobusëve në Prizren. Aty nuk e dimë se kush e menaxhon atë ndërmarrje. Në bazë të të dhënave që disponojmë kemi një kaos të vërtetë të gjendjes faktike. Aty nuk dihet a ka listë të punëtorëve, sa persona marrin rroga, ku shkojnë mjetet financiare që merren nga biletat, e shumë probleme tjera, ku dyshoj se aty menaxhojnë hajdutët dhe banditët. Andaj i bëj thirrje Drejtorisë së Shërbimeve Publike që të shohë nga afër problemin dhe të ndërmarrë veprime konkrete, duke themeluar një bord i cili do të menaxhoj dhe kontrolloj atë institucion të rëndësishëm të komunës. Po ashtu një problem tjetër në kuadër të kësaj Drejtorie është fjala për një deponi ilegale e cila ndodhet tek vendi i quajtur Guri i Beges, rruga Zhur – Dragash. Andaj, i bëj thirrje edhe Kryetarit të Komunës si dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike, të ndërmarrin masa konkrete në mbylljen e asaj deponie problematike dhe e dëmshme për shëndetin e popullatës së asaj ane. Ajo deponi ilegale ju konvenon vetëm grupeve kriminale dhe individëve të cilët kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë interesin e tyre. Aty është një deponi e cila kundërmon erë të keqe me kilometra larg. Njerëzit të cilët i kanë arat në atë pjesë është e pamundur ti punojnë tokat e tyre. Sepse ata rrezikohen nga ndonjë sëmundje e mundshme për shkak të asaj deponie, ku gjuhet gjithçka e rrezikshme (lopë të

ngordhura, qen dhe kafshë tjera të ngordhura). Pjesa dërmuese e pronave janë pronat e fshatit Billushë dhe Poslisht. Me të drejtë qytetarët e asaj ane kanë reaguar dhe reagojnë që të mbyllet ajo deponi ilegale dhe se ata vazhdimisht kanë ngritur zërin me vite të tëra prej se kanë filluar të gjuajnë lloj, lloj mbeturinash të cilat rrezikojnë shëndetin e banorëve të asaj ane. Por që qeverisja kriminale e PDK-së, as që është mërzi për këtë problem serioz. Është e rëndësishme t'ua themi qytetarëve të komunës së Prizrenit që me qeverisjen aktuale janë krijuar mundësi për të jetuar dhe për perspektiven e tyre në qytetin e tyre. Atyre ka filluar tu kthehet dinjiteti qytetarë që më herët e kanë pasur të humbur dhe të nëpërkëmbur. NISMA Socialdemokrate i siguron qytetarët e Prizrenit që fokusi ynë do të jetë në tri gjëra: Do të ketë trajtim serioz institucional dhe respektim maksimal, zhvillim ekonomik si dhe maksimalisht kontribut në politikat e punësimit ku qytetarët do të kenë mundësinë e barabartë për punësim. Ne nuk do të veprojmë siç ka vepruar qeverisja e Ramadan Mujës dhe e PDK-së, qeverisja e dobët me theks të veçantë që nga që nga viti 2010 e këndej. Duke qeverisur me mllef dhe inate, çdo herë të paarsyeshme dhe diskriminuese sidomos ndaj atyre që mendonin ndryshe politikisht. Logjika e tyre qeverisëse ishte që të ndëshkonin dhe sanksiononin çdo qytetar të komunës së Prizrenit, vetëm e vetëm pse ishin votues të ndonjë partie tjetër politike, pra që nuk ishin me PDK-në. Politikat injoruese dhe nënçmuese të Ramadan Mujës dhe PDK-së, kanë marr fund më 19 dhjetor të vitit të kaluar, ata më nuk do të mund të përbuzin qytetarët e komunës së Prizrenit. Siç kanë bërë me vite të tëra nëpër lagje dhe fshatra. Rasti konkret ka qenë me fshatin tim por që nga ne ishte i pa pranueshëm. Billusha për ju ishte problem kryesor që nga viti 2010 e këndej. Ju filluat të hakmerreshit ndaj atyre që ju prunë në pushtet. Ishtit bukëshkelës dhe jo mirënjohës. Billusha ishte ndër themeluesit e para të PDK-së në Prizren. Ju ndihmoj shumë, tej mase, ju dha me mijëra vota për 5 palë zgjedhje, për më shumë se një dekadë 1999-2010. Herë zgjedhje lokale e herë nacionale. Ju pru në pushtet me 2007-2009 dhe 2009-2013. Me të vetmin qëllim për të qeverisur me ndërgegje, përgjegjësi dhe ndershëm. Por ju asnjëherë nuk e betë. Ju përmbysët gjithçka. Madje shkelet mbi çdo gjë. Degraduat çdo vlerë qytetare. Filluat të viheni në dispozicion të hajdutëve të cilët shpesh qeverisnin me Prizrenin me mesazhe nga Prishtina. Krimi dhe korrupsioni në Prizren lulëzonte përmes klaneve të caktuara siç ishte Klani Pronto. E çdo gjë bënit vetëm e vetëm për të kryer misionin ndaj atyre që ju dirigjonin. Ju çdo gjë bëtë, por vetëm një gjë s'mundet ta bënit ndaj qytetarëve të Prizrenit e veçanërisht ndaj qytetarëve të Billushës, nuk mundët ti poshtëronit qytetarët e Billushës, ata nuk u dorëzuan asnjëherë. Bile janë krenar që me votën e tyre ndryshuan pushtetin, rrëzuan nga pushteti Klanin Pronto dhe kështu parandaluan vazhdimin e krimit dhe korrupsionit në Prizren.

Cenet Sajhadi (KDTP): Hepinizi saygı ile selamlıyorum, Sa lık Müdürüne bir sorum olacak bilindi i üzere Kosova Cumhuriyeti Diller Yasasına ba lı olarak Prizren Belediyesi diller yönetmeli ine göre Türk dili Arnavutça ve Sırp dili ile e it statüye sahiptir. Dolayısıyla Prizren Belediye'ye ba lı olarak çalı an Aile Hekimli i Merkezlerinde Türk dili ihmal edilerek ne yazık ki bütün evraklarda Arnavutça ve Sırpça dili kullanılmı tır. Bu eksiklikten bilginiz var mıdır Müdürüm?. Bu eksikli in en kısa zamanda giderilmesini diliyorum te ekkür ederim.

Adem Shabanaj (LVV): Kam vetëm një pyetje për Drejtorinë e Arsimit. Më sa kam informacion, komuna e Prizrenit është e vetme ku i siguron transportin mësimdhënësve. Mirëpo, e kam pasur një takim me profesor të shkollës “11 Marsi” dhe atyre të Kopetencës. E kam parasysh ata paguan prej Ministrisë. Mirëpo, kam dëshirë nga drejtori të di, a ka menduar të bëjë një zgjidhje për ta për transportin. Meqë edhe ata janë punëtor dhe veprojnë dhe punojnë në Prizren.

Haziz Hodaj (LDK): Parashtroi pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, se çka është duke ndodhë më emërimitin e rrugëve dhe shesheve, që është duke zgatur me vite. Edhe komunat më të vogla, edhe komunat më të pa zhvilluara, edhe nëpër fshatra i kanë të shënuara emërimitin e rrugëve dhe shesheve, kurse ne në Prizren ende nuk i kemi bërë. Një pyetje tjetër e kam për Drejtorinë e Arsimit. Është fjala për shkollën e muzikës. Ju e dini që e kemi një vendim të Kuvendit nga legjislacioni i kaluar, për ndërtimin e shkollës së muzikës, në vendin ku ka qenë Benafi përpara. Nuk e di pse po ngec. Kur ka qenë disi si urgjente kërkesa për një vendim për të fillua ndërtimin e asaj shkolle. Në anën tjetër, unë nuk jam ihtar që të merrem me qeverisjen e kaluar. Sepse sinqerisht edhe në mandatin e fundit qeverisja e kaluar është marr me LDK-në, që nga viti 2007 nuk është në qeverisje. Mirëpo tani kur jemi në fillim të një qeverisje të re. Është e pamundur që mos ta përmendim atë gropën e madhe që është krijuar në mandatin e kaluar. Sidomos në mandatin e fundit. Sepse bëhet fjalë për qindra projekte të nisura dhe të papërfunduara. Qindra projekte të nisura pa procedura të rregullta të tenderimit. Dhe është e pamundur sot që nga kryetari Haskuka, të shohim rezultate në tremujshin e parë. Kur dihet se bëhet fjalë për një buxhet të aprovuar nga Kuvendi i kaluar. Mirëpo, unë e thërras kryetarin, ta bëjë një ekip nga anëtarët e Kuvendit, edhe nga anëtarët e pozitës edhe të opozitës. Të vij në Gjonaj dhe të shoh se çka ka ndodh me infrastrukturën në Gjonaj, që nuk funksionon asnjë send. As nuk ka rrugë, as nuk ka ujësjellës në rregull, as nuk ka shkollë në rregull, as nuk ka ndriçim. Që për fat të keq një ndriçim që ka ndodh jo në zgjedhjet e fundit, po në zgjedhjet e parafundit, ku është bo ditën e fushatës. Dje kam marrë vesh që ai qenka ilegal.

Një ndriçim publik që është bo në Gjonaj qenka ilegal. Do më thënë është bërë në kohën e fushatës, pa procedura tenderimi, pa asnjë kriter etj. etj. E njëjta gjë, është edhe me rrugët e fshatit. Unë kam qenë dëshmitarë, bile kam kërkuar prej qytetarëve të dalim edhe ta ndalojmë këtë katrohurë që është ndodhë nëpër Gjonaj. Në kohën e fushatës është hedh asfalt pa procedura të tenderimit, as të ndërtuar infrastrukturë, por është hedh asfalt rrugës. Sot e kemi një gjendje të mjerueshme në fshatin Gjonaj. Unë singerisht nuk jam lokalist. Por po detyrohem me u bo sepse ballafaqohem për çdo ditë me kërkesa nga qytetarët për një gjë të atillë. Andaj, ftoj ta vizitojmë këtë lokalitet. Po edhe të thërras që në rishikimin e buxhetit të parashihet një pozicion për rehabilitimin sado kudo të këtyre rrugëve edhe këtë kësaj gjendje që është krijuar në Gjonaj. Unë e di që anë e kand të Prizrenit ka projekte të atilla të nisura dhe të mbetura në gjysmë. Mirëpo, ta bëjmë një studim një analizë dhe të veprojmë aty ku është më e domosdoshme. Jemi në vitin jubilar të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. E kam një pyetje, ku është Prizreni me përgatitjet. Sepse vitet e kaluara edhe në 130 vjetorin po edhe në vitet tjera, Kuvendi i Prizrenit është marrë me organizmin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Unë kam dëgjua që këtë e ka marrë Qeveria. Mirëpo, ne megjithatë kemi një obligim ndaj kësaj ngjarje, sepse bëhet fjalë për një manifestim të rëndësishëm. Andaj edhe duhet të jemi aktiv ndaj kësaj. Një pyetje tjetër e kam, për klubin futbollistik “Liria”. Ka një vendim të Kuvendit që është më duket në vitin 2013, për mbështetje të klubit. Unë e di që ka procedura, ka çështje të tenderimit për ti ndihmua, për ta subvencionua klubin. Mirëpo, tani jemi në përfundim të sezonit. Bëhet fjalë për pozicionimin se ku do të jetë “Liria”. Është njëra ndër rrugët më të përgatitura në infrastrukturën për tu licencuar në FIFA. Kështu që ju kisha lutur që të ndërmerri diçka, të jeni më fleksibil dhe të ndermirët diçka më urgjente për t’ju ndihmuar dhe për ti zhvillua pastaj ato procedura që duhet. Do më thënë është baza ligjore, është vendimi i Kuvendit. Kështu që nuk prish punë, nëse gjenden mjete, pavarësisht në cilën drejtori, apo të subvencionet e kryetarit. Që të intervenohet te “Liria”. Në mënyrë që mos të jemi ne shkaktar pastaj i rënies së pozitës. Sepse nuk bëhet fjalë i rënies, sepse ajo është në krye të tabelës. Kryesues, ju kisha lutur në seancën tjetër t’ia shpërndash nga një broshurë të Rregullores të Kuvendit, që ti përmbahen kohës. Njëri ndër ata jam edhe unë që do ti përmbahem padyshim.

Sherife Balaj (PDK): E kam një shqetësim po ashtu edhe drejtohet si pyetje për drejtorinë përkatëse, por nuk është vetëm drejtoria për Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, është edhe e Emergjencës, pastaj gjithë komplet komunës së Prizrenit. Familjet të cilat jetojnë në objektin e ish Farmakosit, a është lëvizë diçka në atë drejtim. Kur dihet se tashmë disa prej tyre janë përfitues të banesave në lagjen Petrovë. Në atë lagje e dimë që disa vite veç po

kompletohen banesat, objektet në ndërtim. Dhe në fazën ku e kemi lënë ne kanë qenë të kompletuara dy prej tyre, dhe të pranuar teknikisht. Mirëpo, për shkak të neglizhencës së vendosjes së trafos nga kompania KEDS, ku me muaj të tërë kam bërë kërkesa për vendosje të asaj trafoje. Dhe kompletimit të infrastrukturës të jashtme. Ato familje kanë mbet pa u vendos. Kisha dashtë me na tregua konkretisht ku jemi në atë pikë. Sepse ato familje ende kontaktojnë me mua, dhe kërkojnë që ti jepet sa më shpejtë një përfundim që të vendosen në banesat të cilat tashmë janë përfitues. Një pyetje që e kam bërë në seancën e parë, ku e kemi fillua, ka qenë sigurimi i laptopave për kuvendarët. Pasi që kryetari veç e patë bërë bujë, mungesën edhe prishjen e kompjuterit të vetë. E dëgjova që e kishte ble, e mbajt me shëndete e inshallah ka sende të mira në të.

Ilir Baldedaj: Unë i kam disa pyetje, që dua ti ndaj së bashku me kolegët dhe opinionin. E para duke u thirrur në 100 ditshin e z. Haskuka, i cili për këtë 100 ditësh për pos që gruan e ka marr dhe ka shkua në vizitë zyrtare në Turqi dhe disa fotografive që i ka bërë, le të del publikisht le të na thotë cili është vendimi të cilin e ka marrë në interes të qytetarëve. Përpos që është marrë me qeverisjen e kaluar në konferenca për shtyp dhe disa gjëra të tjera. Nuk ke nevojë me shkua në Turqi, shko në Suharekë e ke afër dhe shiko se si punohet. Edhe aty ku është bërë ndërrimi i pushtetit. Sepse më mirë është më afër, e ke kolegë Balin, se keni qenë deputet, ai ka gjuajt gaz, ti ke pas gjuajt ujë. Kështu që shkoni bisedoni dhe e shihni se si punohet. Pyetje për drejtorin e Arsimit. Keni fol për depolitizim të arsimit, për depolitizim të administratës. E keni mbush administratën me militant dhe sekser të deputetit Rexhep Selimi në Prizren, i cili po bënë presion ndaj shërbyesve civil dhe ndaj qytetarëve. Drejtor i arsimit a je në dijeni që drejtorëve të shkollës nga partia e juaj, është duke iu ofruar librezë partiake në këmbim të vazhdimit dhe të një mandati të drejtorëve të shkollave. A është ky depolitizim, apo është avaz i mëhershëm që ka qenë edhe në vitin 2007 ku vazhdon edhe sot. Ndërsa sa i përket Drejtorisë së Kulturës, në bordin e "Lirisë", drejtori ka ndërhyrje të njëpasnjëshme. Andaj klubi "Liria" është në gjendje të mjerë, nga ndërhyrja e tij arbitrarë. Dhe deri me sot asnjë vendim dhe asnjë mbështetje, ku "Liria" është sot para kolapsit. Të njëjtën gjendje po ky drejtor në vitin 2008 e ka pas sjell "Lirinë" që pretendon ta sjell edhe sot. "Liria" është aset i qytetit të Prizrenit. Shpesh e shoh kryetarin duke bërë selfije aty. Bile të paktën nëse shkoni me bo selfije edhe mbështetni sepse ka borxhe në Hidroregjon, ka borxhe në KEK. Dhe me të gjitha këto ajo është para kolapsit. Pastaj për drejtorin e Shërbimeve Publike. A është bërë diçka për transitin e ri. Sepse partneri i juaj qeverisës në media publike ka thënë. Unë do ti hipi bagerit vetë dhe do ta qeli atë rrugë. Atëherë është mirë nëse nuk kemi mundësi ju, thirrni partnerin dhe vazhdoni

procedurat. Pyetja për kryetarin e komunës është rreth vendimit për anulimin e teleferikut. Kisha dashtë ta di cilët janë ekspertët që kanë vendos për anulimin e teleferikut. Sepse nuk besoj që kryetari e ka marrë atë vendim kokë në vete, pa u konsultuar me ekspertët. Mua më qudit dhe më befason fakti, që Ministri i Kulturës, tani Kujtim Gashi hesht. Kur ka qenë kryetar i komisionit nga asambleja dhe ai projekt ka qenë i Kuvendit. Është dashtë kryetari i komunës, edhe nëse e anulon ta bie në asamble dhe të vendos asambleja. Mënyra se si është veprua, duke pas parasysh aty e kemi pas një vendim të OSHP-së, i cili e ka qua në rivlerësim dhe nuk e ka anulua. Sepse ka mund ta anuloj tenderin. Edhe më qudit fakti se drejtorja përkatëse, Drejtori i Urbanizmit, rreth gjithë kësaj çështje hesht. Apo ndoshta nuk është pyetur fare.

Dafina Bilaca (PDK): Para se të filloj me pikën që unë kam përgatit. Desha vetëm të bëjë një replikë të shkurtë të kuvendarit të Nismës. Siç duket këtë shkrim ta paskan shkruar pikërisht ata të cilët e kanë zhvatur më së shumti pushtetin, kur kanë qenë pjesë e PDK-së. I nderuar nuk jeni në fushatë, por jeni përfaqësues i qytetarëve të Prizrenit. Dhe jeni për të adresuar hallet e tyre. Por po shihet që keni mbet me pasoja nga e kaluara. Dhe duhet ta keni të qartë se fitorja e kësaj qeverie ka ardhur si rezultat i inateve të juaja. Dhe si dëshirë shumë e madhe për tu ulur pikërisht në këto karrige dhe në karriget prapa. Duke manipuluar me qytetarët e Prizrenit, që në jetën e tyre do të bëni ndryshim. Po ai ndryshim po shihet se s'ka ndodh dhe nuk do të ndodh asnjëherë. Të nderuar tani jeni në pushtet, urdhëroni punoni dhe mos u merrni me të kaluarën. Sepse po shihet se nuk keni aftësi të punoni, por vetëm të ankoheni. Ndërsa sa i përket asaj që ju do të qeverisni në dobi të qytetareve, kjo është vetëm një gënjeshtër e juaj e radhës. Sepse pas 100 ditëve në pushtet, keni filluar ti punësoni njerëzit e juaj dhe të zhvatni buxhetin edhe më shumë se nga ata që janë ankuar më parë. Ndërsa tash po kthehem në pikën time që e kam përgatitur. Sepse e ndjeva të nevojshme të bëjë një replikë ndaj asaj që thatë. Për derisa kryetari z. Haskuka dhe drejtorët e qeverisë së tij raportojnë për një 100 ditësh shumë të suksesshëm. Një gjë e cila nuk qëndron fare. Por është vetëm një vetëkënaqësi nga ana e tyre dhe një manipulim me qytetarët e Prizrenit. Ku në realitet gjendja e qytetit të Prizrenit është shumë larg nga kjo që thuhet. Qytetarët e Prizrenit ende ballafaqohen me kushtet më elementare të jetesës së mirëfilltë. Duke filluar nga infrastruktura, ku shumë lagje të qytetit gjenden në kushte të mjerueshme. Qytetarët kanë problem në lëvizje, për shkak të rrugëve të pa asfaltuara dhe pa ndriçim. Si dëshmi të kësaj gjendje kemi pamjet në televizionet lokale, ku paraqitet gjendje e rëndë në lagjen Arbanë, saktësisht në rrugët “Beteja e Pashtrikut”, “Likeni i Hasit” dhe shumë rrugë të tjera të kësaj lagje. Gjithashtu gjendje të rëndë të rrugëve në Prizren kemi edhe në lagjet

“Bajram Curri”, “Jeta e Re” dhe shumë lagje të tjera. Investimi në këto lagje, nuk duhet të anashkalohej, pasi që janë lagje në të cilat çdo ditë e më shumë kemi rritje të banorëve. Si qytetare dhe kuvendare e Prizrenit, kërkoj nga drejtori i Shërbimeve Publike, që urgjentisht të ndërmarr masa në këto lagje dhe në gjitha lagjet tjera që është e nevojshme. Një pikë tjetër shqetësuese. Gjithashtu është uzurpimi i pronave publike. Pamundësia e shfrytëzimit të këtyre pronave po shkakton ngecje në shumë projekte të cilat janë në dobi të qytetarëve. Por për shkak të uzurpimeve të këtyre pronave, këto projekte mbesin të paralizuar. Kërkoj nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, nga Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrit, si dhe nga Drejtoria e Inspektorateve, të bëjnë identifikimin dhe lirin e këtyre pronave dhe ti kthehen në shfrytëzim Kuvendit komunal të Prizrenit. Mirëpo, kërkoj që ky shqetësim i imi të mos mbetet vetëm brenda këtyre katër mureve. Por të merret sinjerisht një punë nga ana e tyre dhe në seancën e ardhshme të kemi veprime apo masa konkrete, të shohim përgjigjen rreth kësaj çështje.

Pranverim Berisha: Unë Dafinë, për dallim prej teje nuk kam kërkuar me qenë në qendër të vëmendjes patjetër, i vëmendshëm jam. Por nuk po ia dinë ti vlerën votës qytetare, prandaj fol. Sepse votën ata të partisë tënde e kanë keqpërdor, e kanë kontrabandua. Edhe besimin e qytetarëve të asaj ane e kanë keqpërdor.

Agnesa Sinanaj (AAK): Çështja që dua ta ngris sot, ka të bëjë me Drinin e Bardhë. Veç sa e përmendi në pika të shkurta z. Sulltan. Besoj që të gjithë ju vetëm e keni parë apo dëgjua. Sepse është bërë shumë mediatike nëpër media lokale, po edhe kombëtare për gjithë ato mbeturina që mblidhen aty. Përveç që e prish bukurinë natyrore që e ka Vërmica, janë edhe shumë të dëmshme. Sepse mund të bartën edhe sëmundje të ndryshme infektive. I nderuar Kryetar, po ju drejtohem juve me një vërejtje. Përveç që nuk keni reaguuar menjëherë pas njoftimeve që janë shpërndarë fillimisht nga iniciatori i gjithë kësaj z. Ramadan Kolukaj, e pastaj edhe të qytetarëve të tjerë. Ajo çka keni bërë ju ka qenë vetëm një postim në rrjetin social facebook me disa fjalë përzgjedhëse, duke treguar se sa shqetësuese është kjo dukuri. Unë ju përgëzoj për fjalët shumë me vend, por ato nuk e zgjidhin problemin. Gjithashtu edhe initiative e juaj për pastrimin e tij është zgjedhje momentale asgjë më shumë. Aty mblidhen çdo ditë mbeturina që vinë nga pjesë të ndryshme të Drinit. Unë propozoj, të bëhet një program apo strategji për mbrojtjen e natyrës si kombëtare ashtu edhe lokale, që jetë më rëndësi, por të jetë edhe e zbatueshme. Gjithashtu një sugjerim tjetër mund të jetë që të kontraktohet një kompani shërbyese e pastrimit. Siç është Ekoregjioni p.sh. që së paku dy herë në muaj që mund ta bëjë pastrimin e tij. Vërmica është vend me shumë vizitor, pikërisht për shkak të liqenit. Por edhe

restoranteve luksoze që janë aty. Që për ta është shumë shqetësuese, që vizitorët të ulën për të ngrënë, e ti shohin ata mbeturina ashtu. Kështu që ju kisha lut, që me pas si prioritet. Çështja tjetër ka të bëjë me uzurpimin e pronave, pikërisht në Vërmicë. I nderuar Kryetar, është mirë ta vizitoni edhe ta shihni se si disa individ i zgjerojnë bizneset e tyre, duke prekur pronat publike. Dhe pavarësisht të reagimeve të banorëve aty, ata vazhdojnë në të njëjtën mënyrë. Bukuritë që i ka Vërmica, ju duhet vetëm pak vëmendje dhe do të thithte shumë investitor, e pastaj mos të flasim për shumë përfitime që do i sjellin këto. Sot e morra përgjigjen e pyetjes që e kam bo për shkollën në Shkozë. Që në fakt të pika e tetë shqyrtimi i propozimvendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm. Unë mendova që është për Shkozën dhe thash sot po u kryeka kjo. Po më sa po shoh, kjo paska mbet për seancën tjetër apo. Atëherë shpresoj që seancën tjetër të zgjidhet ky problem.

Bardhi Avdaj (PDK): Nëse flasim për transparencë, ka disa gjëra që nuk duhet të bëhen reklamë, sepse shihen me sy. Bëhet fjalë për rrugën “Besim Shala”. Dua të flas në emër të mbi 60 kryefamiljarëve, të cilët kanë bërë kërkesën që sot të paktën të diskutohet për mundësin e kanalizimit për atë rrugë. Po mendoj se do të ishte një projekt mjaftë i rëndësishëm. Duke par se ajo rrugë frekuentohet prej shumë qytetarëve të Prizrenit, por edhe shumë qytetarë tjerë. Keni tregua aftësi të mirë në mbjelljen e disa lulishteve, mirëpo primare për qytetarët është kanalizimi.

Edis Aljilji (Vakat): Javljam se u vezi veb stranice opštine Prizren. A vezane za nepoštovanje zakona o službenim jezicima na Kosovo. Ta nije o nepoštovanje jezika u opštinama naseljenim zajednicama, iji materni jezik nije zvani ni jezik. Naime otvaranjme službene veb stranice opštine Prizren. Uvedeo sam tehni ke nedostatki i popust. Za koje ne želim da vjerujem da namerno uradili. A odonose na izbacivanje ili ne uvrstivanje bosanskog jezika kao upotrebi kao jezika u veb stranici. Veb stranica opštine Prizren, je osnovni izvor dobijanja informacija za pripadnika zajednica. I kao takva treba ispunjavati uslovi minimum u smislu poštovanja zakona, principa ravnopravnsti, pristupa informacija svim gra anima koji žive u opštini Prizren. Pored ovih injenica i zakon službenih jezika nas obavezuje isto posebno lan 2 stav 3 Zakona o službenim jezicima. U opštinama naseljinim zajednicama iji materni jezik je zvani ni jezik. I koji ini najmanje 5% ukupne populacije opštine. Jezik zajednice ima e status zvani nog jezika u opštini i koristi e se ravnopravno sa svim zvani nim jezicima. Na osnovu svega iznesenog ostaje mi se da se nadam. Da e ovaj tekni ki propost biti uklonjen u što skorijem periodu.

Kryesuesi: Tani fjalën e ka Prof. Dr. Mytaher Haskuka, që ti jap përgjigjet në pyetjet e parashtruara dhe nëse do të paraqitet ndonjë drejtor që dëshiron të përgjigjet këtu.

Prof. Dr. Mytaher Haskuka, Kryetar i Komunës: Së pari i falënderoj ata që dhanë pyetje dhe sugjerime në këtë seancë. Për disa çështje disa asamblistë po vetë kritikoheni. Shumë probleme uzurpimin e pronës, problemi me mbeturinat. Të gjitha, korrupsionin e probleme tjera që komuna i ka, nuk i kemi prurë, por i kemi gjet aty. Përndryshe, po shkoj nga çështja e fundit që u ngrit. Komuna është kritikuar padrejtësisht për tre muaj për ueb sajt. Ndërsa ueb sajt i ka qenë i menaxhuar nga Ministria e Administratës Publike. Ne i kemi dorëzuar të gjitha informacionet, mirëpo për shkak të problemeve në server, ueb sajt nuk ka punua. Ende ka probleme me të gjitha gjuhët e kështu më radhë edhe besoj se do të rregullohet në ndërkohë. Edhe do të keni ueb sajtin e ri me të gjitha informatat dhe në të gjitha që kërkohet. Unë do mundohem në disa çështje kryesore mu përgjigj. Ashtu si jemi përgjigjur me shkrim në të gjitha pyetjet që i keni parashtruar deri më tani. Do të përgjigjem edhe me shkrim në të gjitha pyetjet specifike. Po pasi më shumti që u debatua, çështja e kontratave. I kemi vetëm dy kontrata mbi vepër deri më tani. Tash e tutje i kemi pa nevojat e komunës edhe do të marrim shumë më shumë me kontratë mbi vepër nga se nuk ka mënyrë tjetër qysh me i krye punët edhe qysh me bo punë në komunë pa këto. Do më thënë kjo është mundësia e vetme. Përndryshe kemi trashëguar me dhjetëra kontrata mbi vepër nga administrata e kaluar. Normal atyre u kalon afati edhe nuk do t'ia vazhdojmë shumicën e tyre. Padrejtësisht këtu po thuhet se ne po anulojmë ose po e ndalim projektin e Karitasit, që janë 76 kontrata mbi vepër, Karitasi i ka dhënë. Atyre u është premtuar tre vjet punësimi e kështu më radhë, gjatë fushatës zgjedhore, janë punësua. Nuk po hy në atë se si janë punësua e kështu më radhë. Unë kam qenë shumë i interesuar për me vazhdua projektin. Ngase mendoj se në shëndetësinë primare duhet sa më shumë me punua dhe sa më shumë me pas njerëz nëse ka nevojë për staf. Por mundësitë buxhetore nuk e lejojnë. Ministria e Shëndetësisë ka financua bashkë me Ministrinë e Mirëqenies Sociale deri më tani. Ka pas kontratë me Karitasin, nuk vazhdon Karitasi, nuk ka të bëjë asgjë me komunën. Nëse vjen te ne, ne jemi të pajtimit që me vazhdua projekti. Nëse Ministria jep fonde. Ju e keni planifikuar buxhetin vitin e kaluar. Në buxhetin e planifikuar, nuk është paraparë paga për këta 76 persona. Prandaj mos e gënjeni opinionin që unë po i ndali 76 kontrata, sepse nuk është ashtu. Një muaj po ja vazhdojmë kontratën, duke u mundua, do më thënë jemi mundua prej fondeve të ndryshme, që nuk kemi me vazhdua me implementua me disa projekte. I kemi sigurua 30.000 € dhe 30.000 € ja kemi dhënë Karitasit që me ia vazhdua kontratat për një muaj.

Më buxhetin që e ka komuna nuk kemi mundësi më shumë. Nëse Ministria e Shëndetësisë edhe Ministria e Mirëqenies dëshiron me vazhdua. Unë jem i mendimit që mundemi me vazhdua, edhe do të jap pëlqimin ne si komunë për me vazhdua projektin. Përndryshe nuk është e vërtetë ajo që nuk jemi të interesuar me bashkëpunua me ministritë e PDK-së. Unë me të gjitha ministritë kam pas takime, dhe po mundohem me pas takime. Jo për shkak të interesave, po për shkak të interesave publike të qytetit të Prizrenit edhe të komunës së Prizrenit edhe të qytetarëve që jetojnë në komunën e Prizrenit. Edhe për këto me Ministrinë e Kulturës i kemi pas disa marrëveshje që i kemi konkretizua edhe i kemi shpallë i kemi në ueb sajt. Ndërsa sa i përket teleferikut, nuk ka mund me u vazhdua ngase është kundër dy ligjeve kryesore të cilët e rregullojnë ndërtimet në komunën e Prizrenit. Po është edhe kundër ligjit për rrjedhat e lumenjve. Do më thënë faktikisht është në kundërshtim me tre ligje. Është dashtë me pas pëlqimin e pesë institucioneve, që është dashtë me dhënë pëlqimin. Urbanizmi ka projektin vetë, edhe i ka dhënë leje vetvetes, Urbanizmi i kaluar. Në atë aspekt një projekt i cili ka probleme me tre ligje edhe me pesë pëlqime. Unë s'mundem me vazhdua, unë vetëm nuk e kam vazhdua. Kurr gjë s'kam pas aty, as kontrata nuk ka qenë e nënshkruar as kurr gjë. Prandaj nuk e ndjej kurrfarë arsytimi ose problemi për këtë çështje. Dhe e kemi sqaruar edhe me personat të cilët merren me këto çështje. Do më thënë nuk ka kurrfarë problemi në aspektin e komunës. Nuk do të kemi kurrfarë pasoja me këtë plan. Përndryshe edhe unë jam i mendimit për një teleferik më ndryshe, i cili nuk e cenon qendrën historike të Prizrenit. Nuk e shëmton pamjen e Kalas së Prizrenit. Nuk e shëmton pamjen e Marashit. Edhe është në përputhje me ligjet në fuqi. Vetëm platoje lartë është katër kate, pesë metra afër murit të Kalas. Edhe sipas projektit është paraparë aty 1500 metra katror. Çka po vyejnë 1500 metra katror për një teleferik. Pyetja ime është shumë bazike. Edhe për atë nuk do të vazhdohet ky projekt. Çështja e zëvendësdrejtorëve, unë nuk po di ku keni ndie zëvendësdrejtor. Zëvendësdrejtorët nuk ka asnjë zëvendësdrejtor. Bile po kërkoj çdo ditë me pas njerëz të cilët munden me i ndihmua. Unë deri më tash nuk kam dhënë leje për asnjë punësim. Po faktikisht ju i keni informatat më shumë se do njerëz aty në administratë më përpara ju po ju japin shënime se sa mua si kryetar komune. Prandaj ju po i dini më mirë do gjëra se sa unë vetë. Në aspektin e vizitave, deri më tani i kam pas shtatë vizita. Tri njëditore, kam fillua në Mal të Zi. Ku kam qenë me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Ka qenë e paguar krejt nga Ministria. Edhe faktikisht i kemi diskutua çështjet ose problemet të cilat i ka komuna. Edhe qeveria është faktikisht e juaja. Ajo qeveri e juaja mi ka pagua shpenzimet që kam shkua atje. Kryeministri është i AAK-së, ndërsa partneri kryesor është i PDK-së. Ju po më kritikoni për shpenzimet. Prandaj ka qenë thirrje e qeverisë, ma kanë dërguar thirrjen, unë kam shkua. Në vizitën tjetër,

kemi qenë në Amassya, për këto disa ditore po foli. Faktikisht paraprakisht unë vetë kam qenë në Berlin, për dy ditë. Në Berlin ka qenë me thirrjen punëve të Jashtme të Qeverisë Gjermane. Ka qenë e paguar tërësisht prej Qeverisë Gjermane. Nuk ka pas kurrfarë ngarkese buxhetore për komunën. Përndryshe si rezultat i kësaj vizite, Prizreni është kthye në vendimmarrje për kampin e KFOR-it Gjerman. Deri në atë moment që kam qenë atje Prizreni nuk ka qenë i kyçur në bisedime se çka do të ndodh me KFOR-in Gjerman, edhe si do të përdorët kampi i KFOR-it Gjerman. Kampi i KFOR-it Gjerman, e di që qeveria e kaluar ka qenë e konsultuar. Neve nuk na kanë dhënë asnjë informatë të vetme, se çka kanë bo me GIZ-in, ose çfarë biseda kanë bërë me GIZ-in. Nënkryetari Eshref Memaj, ka dashtë me kontaktua, nënkryetarin e vjetër, i cili ja ka mohua tërësisht informatat se çka komuna ka bo lidhur me KFOR-in Gjerman në katër vitet e kaluara. Edhe faktikisht nëpërmjet Qeverisë Gjermane në Berlin, unë duhet me mësua se çka po bëhet në komunën e Prizrenit. Tani komuna e Prizrenit është në grupin drejtues për KFOR-in Gjerman, dhe ky kamp siç e dini ka mu kthye në qendrën për inovacione dhe trajnime. Edhe do të menaxhohet një kohë nga GIZ-i pastaj nga ndonjë kompani Gjermane. Po ne do të jemi ata që po ashtu do të marrim pjesë edhe do të vendosim për këtë vend në të mirën e qytetarëve të komunës së Prizrenit. Në Amassya kemi qenë në takim trepalësh në takim të Amassyas, Berati edhe Prizreni. Po edhe shoqja ime ka ardhur, unë i kam pagua vetë shpenzimet e sajë. Në aspektin Amassyas, kemi shkua edhe një grup të shoqërisë civile edhe të Ministrisë të Kulturës zyrtarë. Ngase bisedimet kryesore kanë qenë lidhur me UNESCO-në. Berati është pjesë e UNESCO-së, Amassya ka hy në listën e UNESCO-së. Edhe këto qytete të cilat janë të binjakëzuara. Do më thënë Prizreni është i binjakëzuar me Amassyan, Amassya edhe me Beratin. Kanë informata të mira se çka duhet të bëjë Prizreni për disa monumente. Ngase aq shumë e kemi shkatërruar qendrën historike të Prizrenit, gjë që është e pamundur me hy në listën e UNESCO-së. Po na thanë që ndoshta disa pjesë të qendrës historike të Prizrenit, mundemi mi shti në listën e UNESCO-së, nëse tash merrni ndonjë veprim. Edhe e falënderoj drejtorin e Inspektoratit i cili po bënë një punë të shkëlqyeshme. Përkundër bllokimeve që po bëhen nga disa institucione nga qendra në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Prizren. Pos kësaj kemi bo marrëveshje bashkëpunimi edhe me Beratin aty. Edhe pse Berati nuk është i binjakëzuar me Prizrenin. Kemi fol me kryetarin e Komunës, ai do të na vizitoj më 27 prill, këtë javë Prizrenin. Edhe me krye bashkiakun e Beratit, nëse pajtoheni edhe ju, po mendojmë ta binjakëzojmë Prizrenin edhe Beratin. Edhe me njëfarë aspekti pasi janë edhe qytete historike, besoj që duhet edhe të binjakëzohen. Po edhe me Amassyan kemi pas marrëveshje të caktuara. Edhe për shkëmbimin e studentëve edhe për marrëveshje për bashkëpunim ekonomik lidhur me panairët

që organizohen në qytetin tonë, po edhe në qytetin e tyre. Njëjtë edhe në Bingen, është hera e parë që një kryetari i komunës së Prizrenit viziton Bingenin. Edhe pse është 50 vjetori binjakëzimit të Bingenit. Kanë pas kontakte ata kanë këtu disa herë, disa zyrtarë kanë shkua atje. Po nuk ka pas kurrfarë marrëveshje me Bingenin. Ne kemi konkretizua me Kryetarin e Bingenit disa çështje si p.sh nxënësit e shkollës së muzikës, të shkojnë së paku nga një muaj atje dhe nxënësit e shkollës së muzikës të Bingenit të vinë këndeje në familje të Prizrenit, dhe të shkojnë në shkollën e muzikës në Prizren. Dhe se muzika nuk ka gjuhë, dhe me njëfarë aspekti i bashkon. Po edhe çështje tjera lidhur me ekonominë. Sidomos revitalizimin e lidhjeve tregtare që të kanë bëjnë me prodhimin e verës në Prizren dhe shitjen e sajë në Bingen dhe në Gjermani. Kam qenë në Tiranë te Erion Velijaj, me thirrjen e tij, kemi pas një takim lidhur me bashkëpunimin, ajo ka qenë ditore. Shpenzimet e naftës, normal janë. Kam qenë edhe në Kukës dy herë, edhe krye bashkiaku i Kukësit ka qenë një herë këtu. Mendoj që Kukësi do të jetë një ndër qytetet që do të kemi një bashkëpunim shumë të mirë. Sidomos në aplikime për fonde të Bashkimit Evropian. Këto ishin lidhur me vizitat. Do ti shihni edhe rezultatet e tyre edhe në ditët e ardhshme. Unë do ti vazhdoj vizitat, mënoj se një detyrat e kryetarit është pa ashtu që të krijoj lidhje për ekonomin, arsimin, shëndetësinë në shtetet të cilët mund të na ofrojnë ndihmë. Sa i përket padive janë 3700 padi, ku 90% janë kundër komunës. Vetëm infrakosi i ka 96 padi ndaj komunës. Sipas infrakosit komuna i ka humb infrakosit 8 hektarë. Po 8 hektarë janë tepër shumë në qendrën e Prizrenit. Për shkak të këtyre padive neve për çdo ditë po na mirën edhe para prej xhirollogarive përmes përmbaruesve. Që deri më tani janë 1.000.000 € me përmbarues që na i janë marr. Po në të njëjtën kohë edhe na është pezulluar plani i zhvillimor komunal. Plani zhvillimor komunal e ka pezulluar një vendim pak si absurd i gjykatës. Po gjykata ka vendos në këtë mënyrë derisa merr vendim për një vendim që ia ka bërë Hekurudha komunës. Me vet faktin që jemi duke punua për pastrimin e Vërmicës edhe Drini i Bardhë nuk është pjesë e kompetencës së komunës. Unë jam mundua me ngritë vetëdijen për ndotjen që është në Lumbardhë dhe në Liqenin e Vërmicës. Pas asaj ka pas shumë aktivitete. Edhe aktiviteti kryesor ne kemi qenë edhe me Shoqatën e Peshkatarëve, të punojnë çdo ditë aty. Edhe Ekoregjioini është duke i ndihmuar, që me pastrua sa më mirë atë pjesë. Uzurpimet që janë bërë aty janë katastrofale. Po mundem me tregua një ndërtim i cili ka diku rreth 5.000.000 € është total pa leje aty. Është një ndërtim i cili është një pjesë në pronën publike. Është në pronën e Agjencisë së Pyjeve të Kosovës. Po edhe kjo nuk ka ndodh brenda tre muajve, po ka ndodhur në dy-tre vitet e kaluara. Bile një nënkryetar i kaluar ka shkua aty edhe e ka bo promovimin e asaj ndërtese e cila është tërësisht pa leje, edhe që është bërë në pronë publike. Tash çështja e

këtyre gjërave ne do ti adresojmë të gjitha një nga një. Unë i falënderoj të gjithë drejtorët të cilët punojnë shumë në këtë çështje. Sidomos e kemi prioritet rregullimin e çështjes së pronës publike. Ngase të gjitha uzurpimet e pronës publike, do ti kthehen mbrapa komunës. Deri në fund të mandatit të gjitha pronat e komunës do të dihen me emër e me mbiemër te kush ka shkua, edhe si do të kthehen në të mirë të komunës. Që mos të keqpërdorën nga individ të caktuar. Lidhur me Zhupen, e kemi bërë një marrëveshje me Ministrinë e Zhvillimit Rural. Diku 450.000 € investime në disa fshatra të Zhupës. Prej infrastrukturës e cila mungon po edhe për rregullimin e rrugëve të cilat janë ndërtua, të cilat kanë probleme me mirëmbajtje. Edhe për shkak se janë ndërtua me njëfarë aspekti në mënyrë të shpejtuar, pa i bo muret mbrojtëse. Ka pasur shumë rrëshqitje të dheut edhe një pjesë e këtyre fondeve do të shkoj në sigurimin e këtyre rrugëve. Po në të njëjtën kohë edhe për kanalizime, për ujëra, për ndërtimin e qendrave të kulturës. Dhe shpresoj që do të vazhdojnë investimet. Projektet janë duke u bo. Përndryshe e di që kemi problem. Po e kemi raportin e publikuar, kërkoj falje. Raporti në gjuhën boshnjake dhe turke ende nuk është përfundua. Po merr pak kohë me përkthyes, ngase po kanë edhe shumë punë tjera. Po besoj që edhe ato do të jenë në ueb sajt. Ata që donë me ditë atë që e kemi bo për 100 ditë, i kemi aty. Besoni kemi bo edhe shumë më shumë. Po për shkak të raportimit, si kemi mund me i raportua ato të gjitha që janë bo. Unë mendoj që ka probleme. Jam për kritikë. Falënderoj shumë për çështjen e ngritur për 120 shtëpi për tek lagja Gurishte. Jemi mundua me dy tre mënyra me gjet zgjidhjen më të mirë për këtë vend. Edhe shkuam me KOST-in me bo sa më shpejt. Që KOST-i me na lirua një pjesë të tokës aty, që rruga me kalua nëpërmes rrugës të KOST-it. Po këtu ka probleme, duhet me bo shpronësimin. Shpresoj që në seancat e ardhshme do të kemi këtë kërkesën për shpronësim. Për pyetjet tjera besoj që edhe drejtorët mundën me ju përgjigj.

Skender Susuri, drejtor i Arsimit: Fillimisht i përshëndet të gjithë kuvendarët për pyetjet që janë adresuar në Drejtori Komonale të Arsimit. Mirëpo, për ta kursye kohën, unë do të përgjigjem vetëm në disa nga këto, kurse të tjerat do ti japim me shkrim. Ka qenë një interesim i kuvendarit Sallauka, rreth gjendjes në shkollën “Lek Dukagjini”. Vërtetë situata është e tillë. Për sa i përket sigurisë së nxënësve, aty ka mungesë sigurie dhe infrastrukturës shkollore. Sepse është një infrastrukturës shkollore e vjetruar. Mirëpo, ne me kryetarin Haskuka e kemi prioritet shkollën “Lek Dukagjini”. Dhe ky prioritet dëshmohet edhe me një dokument konkret që e kam këtu. Kryetari Haskuka e ka miratua një konkluzion, përkatësisht një vendim, që në atë shkollë të intervenohet sa më shpejt. Sidomos në rregullimin e ambienteve të jashtme. Mirëpo, me shikimin e gjendjes që unë e kam bërë në atë shkollë, lyp shumë më

shumë investime. Ne do ta bëjmë me ndihmën edhe të juve si kuvendarë, me rishikim të buxhetit. Sepse ne e kemi një politikë, që dy shkollat më të mëdha në Prizren “Lek Dukagjini” dhe “Abdyl Frashri”, nga një shtatori ti ndajmë si shkolla të veçanta, shkolla fillore të mesme dhe të ulëta. Dhe për ta realizuar këtë nevojitet një pozicion buxhetor kur është fjala për “Lek Dukagjinin” dhe shpresoj se kjo do të bëhet. Pyetjet e tjera kanë qenë shumë interesante, sidomos nga kuvendarët që e kanë trajtuar çështjen e gjithë përfshirjes. Prioritet i joni i Drejtorisë Komunale mbetet gjithë përfshirja. Ne e kemi nënshkrua dhe marrëveshje me Karitas Kosovën, e cila do të jetë funksionale nga 1 shtatori 2018. Dhe ka të bëjë me funksionalizimin e shërbimeve psikologjike, pedagogjike në nivel komunal. Ku do të jenë një staf prej 10 personave dhe më siguri me këtë staf ne mendojmë që shtrirjen e përgatitjeve të tija të gjitha produkteve tjera që nevojiten për kategori të fëmijëve, komuna jonë do të jetë model në Kosovës, nuk po them vetëm formalisht. Dhe pyetja që unë detyrimisht duhet ti përgjigjem. Është pyetja që ka të bëjë me kuvendarin e nderuar Baldedaj. Është e vërtetë që ne kemi premtua depolitizim. Dhe depolitizimin do ta bëjmë. Por ne nuk mund ti ndalojmë personat të cilët bëjnë akrobacione politike. Kalojnë nga një subjekt në subjektin tjetër. Kjo është një dukuri jo e mirë. Kjo ka ndodh edhe në të kaluarën. As Skender Susuri, as Mytaher Haskuka, nuk mundën mi ndalua të tillën, sepse e kanë zanat. E këtë zanatin e kanë trashëguar më herët. Ndërsa që kjo transparencë është e evidente. Unë me rekomandimin e kryetarit Mytaher Haskuka kam qenë i obliguar me hartua një udhëzues, për procedurat e zgjedhjes së drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në shkollat e komunës së Prizrenit. Ky dokument shpresoj se është bërë publik në faqen zyrtare të komunës sot nga vetë kryetari. Dhe nëse e lexoni pikën 17, kalon përtej asaj çka e thotë dispozita ligjore. Në vlerësim të kandidatëve do të jenë edhe dy përfaqësues të këtij Kuvendi komunal, prej momentit të parë. Përveç që janë prind edhe këshilli i shkollës e kështu më radhë. Dhe dy përfaqësues nga shoqëria civile, të cilët merren me tema nga arsimit. Dhe nëse e lexojmë pikën 22 thotë: Pikëzimi i të gjithë kandidatëve do të ndodh pikërisht në prezencën e këtyre kandidatëve aty për aty. Nuk do të ketë pikëzime si në të kaluarën pas një javë dite.

Drejtoresha e Shëndetësisë Flaka Siçeca: Sa i përket çështjes së mamografisë që u ngritë, njëra ndër metodat më të mira për luftën botërore kundër kancerit është metoda e skrilingu, apo kontrollimi para se me fillua fazat e avancume të sëmundjes. Në institucionet shëndetësore të komunës së Prizrenit, është e punësuar vetëm një radiologe, e cila ka qenë drejtoreshë e Shëndetësisë në të kaluarën. Sigurisht se ajo vetë po e ka të pamundur numrin e madh të cilat duhet me iu nënshtruar mamografisë. Një ide të cilën e kemi

mëndua na. Sepse zakonisht skrilingu është bërë rreth muajit tetor, kur është muaji i kancerit të gjirit. Mirëpo, për shkak të nevojës së madhe ndoshta me punësua një radiolog tjetër me kontratë mbi vepër. Sepse nuk na lejohet me ligjin e ri të shëndetësisë me punësua specialistë. Do më thënë këta specialistë që janë do të kryejnë punën e tyre deri në pensionim. Dhe institucionet e shëndetit primar do të mbetën vetëm me mjek të mjekësisë familjare. Do më thënë si punësim nuk është e mundur, për shkak se është në kundërshtim me ligjin për shëndetësi primare. Mirëpo, si punësim i përkohshëm me kontratë mbi veprën me ndonjë mundësi është menduar. Po ashtu ju informoi që QKMF-ja në bashkëpunim me Spitalin rajonal të Prizrenit edhe një organizatë joqeveritare do të fillon edhe bërjen e PAP testeve fala. Do të filloj me një grup të vogël. PAP testi është një test i cili është i rëndësishëm për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës. Ndërsa sa i përket rolit tim në konkursin i cili qenë i herës së kaluar, dhe konkurset tjera. Roli im ka qenë vetëm monitorues, aty ka qenë edhe sindikata edhe të gjithë. Dhe unë mendoj që Drejtoria e Shëndetësisë duhet të jetë monitoruese e këtyre proceseve, për shkak të konkurrencës shumë të madhe. Edhe Udhëzimit administrativ i cili është shumë i përpiktë. Edhe kërkon shumë, shumë procedurë pra me qenë në rregull. Do më thënë roli im është vetëm monitorues dhe do të vazhdon të jetë monitorues. Ndërsa pyetja e deputetes rreth materialit të veçantë mjekësor, pse nuk është në gjuhën turke, nëse e kuptova drejtë, se nuk pata përkthim. Materiali i veçantë mjekësor krijohet prej Ministrisë së Shëndetësisë. Dhe për shkak se në nivel qendror gjuha turke është gjuhë lokale. Nuk figuron gjuha në ato dokumente. E ne ato dokumente nuk guxojmë as me shtyp vet, këto janë të veçanta që vinë prej Ministrisë. Unë çka mundem me bo është me e dërgua një kërkesë në Ministrinë e Shëndetësisë për shkak të rrethanave të veçanta që i ka komuna e Prizrenit. Për shkak që e ka numrin e madh të komunitetit turk edhe që punon në institucionet tona, përveç asaj. Ajo është diçka të cilën unë mundem si qeverisje lokale me ia drejtua Qeverisë qendrore. Kërkesa, cilat mjete mungojnë na vinë neve prej shefave të stomatologjisë të reparteve. Tash për furnizimin e ardhshëm kemi kërkuar nga shefat me na dorëzua listën. Mjetet, pajisjet janë me një shumë të caktuar. Mirëpo e mira është që pajisjet stomatologjike është vijë e veçantë buxhetore. Prandaj unë do të interesohem specifik për këto dy dhoma që po pyet. Mirëpo, edhe në përgjithësi për ato kërkesat se cilat janë. Sepse ndonjë herë me 10.000 € për karrige stomatologjike, nuk plotësohen nevojat me një vijë buxhetore.

Vjollca Kabashi: Nuk është çështja për karrige stomatologjike. Mirëpo, për llamba, për gërryese të dhëmbëve. Dy dhomat specialistike të fëmijëve nuk ishin të pajisura me mjete të punës. Kjo çështje ishte shumë herët. Kanë

diskutua me shefat, kush ka qenë nuk e di. Më gjithë se ndahet buxhet i veçantë. Pse ju, përpara keni LVV-je si opozitë. Për çfarë arsye nuk kanë shkua opozita ta vizitojnë atë qendër më herët edhe të paraqesin rastrin. Edhe tash prapë vazhdon e njëjta gjë.

Siçeca: Do të interesohem se a ka ardhur kërkesa. Sepse kërkesa vjen prej mjekut i cili punon me ato mjete. Do më thënë ashtu shkon procesi, kam nevojë për pesë ekg. Do ta kem parasysh.

Drejtori i Mirëqenies Sociale Fejz Kabashi: Te autizmi e ka ngritë një çështje dikush. Drejtorja e Mirëqenies Sociale ka pas një thirrje publike për ndihmë OJQ-ve që ofrojnë shërbime qytetarëve të komunës tonë. Prej raportit që ma ka dhënë komisioni, autizmi do të përfitoj. Nuk e di ende sa, jemi në përfundim e sipër të kësaj çështje me kryetarin. Sa i përket çështjes së lypsarëve që e ngriti kuvendari Petriti, pothuajse që tre muaj e kërkoj një objekt, një qendër komunale, t'ia jap një organizatës që do ti trajtoj fëmijët në këtë situatë të rrugëve. Për momentin s'po mund të gjej objekt të pronës komunale për me ua dhënë në shfrytëzim. Shpresoj që do ta gjejmë. Do ta krijojmë në të ardhmen vetë një qendër. Dikush tjetër ka ngrit çështjen e personave me aftësi të kufizuar. Që shumica prej tyre, nëse keni mendua në ato aftësitë fizike. Po janë rreth Hendikosit, edhe Hendikosi prapë futet si autizimi në njërin nga organizatat që do të përfitoj nga komuna. Ndërsa sa i përket Farmakosit që e ngriti kuvendarja Sherifja, kuvendi në mbledhjen e kaluar ja ka dhënë Ministrisë së Kulturës. Aty për fat jetojnë disa familje skamnore dhe ka prej tyre që nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit. Disa prej tyre ju i përmendet që kanë përfitua, janë shumë pak, ka edhe asi që s'kanë përfitua. Është shqetësim i jashtëzakonshëm se ata do të dalin në rrugë. Unë i kam kërkuar kryetarin dhe jemi në konsultim e sipër të gjejmë një formë bashkëpunimi me Ministrinë. Ata që nuk e kanë të zgjidhur statusin e banimit, t'ua zgjidhim urgjent përmes qirasë. Përndryshe nuk ka formë tjetër. Tek Petrova, pothuajse është në fund të përfundimit të çdo punimi dhe qytetarët ti gëzojnë ato që ju i keni ndarë të kaluarën. Nuk ka pas leje për ujë, s'ka pas ujë, s'ka pas rrym. S'ka pas as leje për rrymë. Të gjitha janë rreth përfundimit. Po shpresoj, po ju them publikisht që më ka thënë ai i fundit, që ende s'ka përfunduar lamela e tretë. Ai më ka thënë se në fund të qershorit publikisht deklaroi se do ta dorëzoj. Unë planifikoja ende pa e dorëzuar ai të tretën, të parën dhe të dytën të filloj mi vendos banorët.

Ehat Oreshka, drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport: Sa i përket pyetjes nga z. Haziz Hodaj në lidhje me 140 vjetorin e Lidhjes së Prizrenit, kamë qenë qenë edhe para disa ditëve në një komision Qeveritar për organizimin e 140 vjetorit të Lidhjes së Prizrenit. Dhe aty janë marrë disa

vendime në lidhje me organizimin e manifestimit. Kështu që ne jemi duke e përpiluar një program që mos të bimë ndesh në aktivitete. Dhe programi i jonë si Kuvend komunal dhe si drejtori do të jetë në harmoni me programet e Qeverisë, që i kanë planifikuar që të kenë disa aktivitete, disa simpoziume shkencore. Akademia e Prishtinës dhe Shkupit janë së bashku në këtë manifestim. Për çdo informatë tjetër do të jemi në kontakt me Qeverinë, që e kanë një komision. Sa i përket “Lirisë”, në fillim të mandatit i kemi pagua 200.000 €, 80.000 € klubit futbollistik “Liria”, 80.000 € “Bashkimit” edhe 40.000 € Teatrit Profesionist, në fillim të muajit shkurt. Një bisedë me ushtruesin e klubit futbollistik “Liria”. Ishte që këto mjete që janë lëshua, ishin mjete të vitit 2018. Dhe u dakorduam që me këto mjete të përfundojmë sezonin deri në përfundim, diku ka mesi i muajit maj përfundon kampionati. Mirëpo, pas disa ditëve prapë ushtruesi i detyrës vjen kërkon mjete, me arsyetim që të gjitha ato mjete janë shpenzua duke paguar borxhet e vjetra. Unë nuk e di saktësisht si është puna e klubit “Liria” në aspektin financiar. Sa i përket organizimit, unë nuk kamë ndërhyrë në asnjë rast në klubin e “Lirisë”. E dyta sa i përket organizimit të brendshëm, bordi ka disa anëtarë. Ata kanë marrë disa lojtarë nga Shqipëria edhe trajner, ku kanë bërë disa kontrata. Ndoshta për kushtet tona, janë kontrata pak më të larta se sa që meritojnë ata, apo si është edhe tregu i futbollistëve në Kosovë. Për këtë arsye tash problemi i tyre është tash aty që nuk po munden të paguhen borxhet. Nuk po munden të paguhen kontratat e trajnerëve dhe lojtarëve. Ky është problem i tyre. Ndërsa asnjë ndërhyrje nuk kam pas. Për atë arsye nuk po dua me zgjatë bisedën z. Ilir, për hir të korrektësisë, edhe për hir të respektit që kam ndaj juve edhe ndaj qytetarëve. Dëshiroj të reflektoj pozitivisht. Vetëm ta sqaroj shkurt. Koordinator i është emëruar në klubin “Liria”, ai nuk është emërim partiak. Ai e ka emrin Gëzim Hasi, që ka luajtur futboll më tepër se sa që ti ke moshë. Kështu që të kemi parasysh atë. Ai nuk ka ardhur si bord që është emëruar, por ai koordinator është. Ka shkua ashtu si ka meritua, si koordinator, si trajner i futbollit.

Islam Thaqi, drejtor i Drejtorisë për Inspektorat: Sa i përket pyetjes së parashtruar nga Alush Shala, në lidhje me largimin e veturave nga ish Benafi, ndoshta kam qeni i shkurtër në përgjigje mirëpo puna është kështu: Dua ta shpjegoj se Inspektorët e bëjnë verifikimin, mirëpo në procedurë e sipër na merr shumë kohë përmes organeve përgjegjëse derisa të gjenden pronarët e vërtetë të veturave. Do të thotë që është procedurë që zgjatë përafërsisht një muaj. Ne s’mundemi me ia konfiskua dikujt diçka pa e verifikua te organet përgjegjëse. Do të thotë organet e policisë edhe qendra e regjistrimit të veturave. Kontaktohet pala, informohet edhe konfiskohet apo largohet vetura. Janë disa

pika edhe jemi në proces e sipër, ku do të merren masa për largimin e tyre. Ndërsa sa i përket pyetjes së Petrit Hoxha për çështjen e lypsarëve. Është vërtetë shqetësuese dalja e lypsarëve në qytet, veçmas në qendrën historike të Prizrenit. S'kalon dy minuta po sa ulësh me një lokal, vjen një lypsar. Nga hulumtimet që i kemi bërë, realisht ekzistojnë tri grupe lypsarësh. Është grupi lypsarësh që vinë në mënyrë të koordinuar, që vinë nga Shqipëria. Është një pjesë e shoqërisë tonë që kanë dal me trauma të ndryshme nga lufta, që ne i njohim. Edhe pjesa tjetër që është e pa sinkronizuar. Me organet përgjegjëse me organet e policisë të Kosovës, e kemi diskutua këtë çështje. Mendoj se jemi në proces e sipër. Mirëpo, neve në zbatim të kësaj na nevojitet një qendër e mbajtjes, veçmas për fëmijët. Edhe për identifikimin e bosëve, në këtë rast të lypsarëve që vinë nga Shqipëria. Mirëpo, besoj që shumë shpejt, brenda muajit maj do të marrim aksion për largimin e lypsarëve nga rrugët e qytetit. Zonja Mimoza Bushrani, mi ka parashtrua dy pyetje. Të ndalohej shitja e produkteve të qumështit në tregun e Bazhdarhanës. Realisht tregu i Bazhdarhanës është një ndër tregjet më të ngarkuara. Aty ka kërkesa nga qytetarët të largohen edhe shitësit e fidanëve, luleve e ku di unë. Kështu që besoj që shumë shpejt do të dalim me reagim. Këta duhet të jenë i vetmi treg që për afërsisht është diskutabil është tregu në Ortakoll, tregu i gjelbër. Ai pak a shumë i plotëson kushtet për shitjen e produkteve të qumështit. Jemi në proces e sipër të kësaj, besoj që qysh të mërkurën tjetër do të dalim në veprim. Të ndalohej shitja e shitjeve të cigareve me copë nëpër kioske. Këtë kemi filluar javën e kaluar me inspektorët sanitar. Janë duke i vizituar të gjitha kioskat në afërsi të shkollave dhe do të ndëshkohen nga inspektorët sanitarë për këtë punë. Ndërsa sa i përket pyetjes së parashtruar nga znj. Dafina Bllaca, për çështjen e lirimit të pronave të uzurpuara. Besoj se javën tjetër komisioni do të filloi punën, i cili do të bëjë verifikimin e të gjitha pronave të uzurpuara. Na e kemi paraparë që kjo të bëhet në mënyrë zonale. Për arsye që ta kemi pasqyrën sa më të qartë, ku dhe si. Edhe pastaj do të dalim në veprim të gjitha drejtoritë së bashku.

Pika e katërt:

Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, për vitin 2018

Për njoftim për anëtarët e Kuvendit, në mbledhjen e parë të mbajtur në këtë sallë, më datën 15 janar e patëm formuar një grup joformal me përfaqësues nga secili subjekt politik, i cili ka pas për detyrë të bëjë hartimin e një drafti, që besoj se e keni parë në materialet që i keni marrë. Rreth planit vjetor të punës të këtij Kuvendi. Deri më tani janë mbajtur dy takime joformale, me shefat e

grupeve, me anëtarët e Kuvendit, me përfaqësues nga ekzekutivi. Dhe se kemi arrit deri në një pikë ku e kemi formua këtë draft. Pas këtyre dy takimeve, ky draft është shqyrtuar edhe në KPF-ca dhe aty janë bo disa ndryshime. Është fjala për muajin maj. Ku në vend ku janë paraparë rregulloret nga Drejtoria e Arsimit, në vend të rregullores për adresimin e dhunës dhe parandalimin e përdorimit të substancave narkotike në shkollë. Është kërkuar që të vendoset në muajin qershor. Dhe në vend të sajë në muajin maj, të përfshihet rregullorja për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta. Pra, kjo ka ardhur si kërkesë e Drejtorisë së Arsimit. Sepse rregullorja e cila është lënë për muajin qershor. Kërkon një angazhim të shumë segmenteve. Duke përfshirë policinë, instancat e sigurisë. Dhe se deri në muajin qershor besoj që do ta kemi të finalizuar. Pra, këtu është bërë një ndryshim. Unë e hap diskutimin, për ndonjë propozim, ndryshim apo diçka tjetër. Kush e donë fjalën?

Agnesa Sinanaj: Desha vetëm një sqarim me bo. Të pika 8 e rendit të ditës kam mendua që është për shkollën në fshatin tim në Shkozë. Pasi që mbet për muajin tjetër, atëherë le të jetë përnjëmend për muajin tjetër. Se edhe muajin e kaluar keni thënë që do të jetë për këtë muaj. Mos të ndodhë e njëjta gjë edhe muajin e ardhshëm. Sa i përket çështjes tjetër në lidhje me pronat private, ku kryetari ceki, për ato prona që janë mbi 5.000.000 € Sipas informacioneve që i kam unë, nuk është pronë publike, po është pronë private. Edhe kur e bëra unë kërkesën nuk ke fjala për këtë. Po ke për do prona tjera, që i uzurpojnë do persona tjerë. Vetëm këtë desha me sqarua. Ndërsa sa i përket punës së Liqenit, që tha se është duke punuar në këtë drejtim Shoqata e peshkatarëve dhe Ekoregjioni. Nuk është e vërtetë, se arsyeja pse u vonova unë këtu, është se kesh deri te Drini i Bardhë, dhe është po në të njëjtën gjendje, sikurse çdo ditë. Ata asgjë nuk kanë punua, përveç atë ditë që kanë qenë me kryetarin bashkë.

Haziz Hodaj: Unë duke marrë parasysh që ky plan është diskutua në të gjitha nivelet e Kuvendit. Edhe duke marrë parasysh atë që është plan orientues. Unë po kërkoj që me aprovua këtë plan. Sepse tek e fundit, është orientues. Edhe sigurisht se duhet të jetë fleksibil, se pastaj gjatë qeverisjes mund të dalin edhe kërkesa tjera edhe pika të rendit të ditës, që nuk kanë ndalës. Kështu që si plan orientues është mirë, mos me debatua po me aprovua.

Ganimete Babuna: Ne si grup i kuvendarëve të Nismës Socialdemokrate, Plan Draftin e punës së Kuvendit për vitin 2018, e kemi analizuar me kujdes dhe kemi ardhur në përfundim se ky plan është i mangët. Ngase në këtë plan nuk janë të përfshira disa raporte ne planë. Që do ta forconin punën e këtij Kuvendi për këtë vit. Unë po i përmendi vetëm disa. Siç është raporti i punës për zyrën e prokurimit. Raporti i qendrës historike. Raporti i

kompleksit Evropa. Raporti i klubit futbollistik “Liria”. Raporti i të gjitha komiteteve apo trupave punuese, që dalin nga Kuvendi. Nuk është plani komunal i veprimit për barazi gjinore, si dhe raporti nga kjo zyre dhe disa të tjera. Nuk po themi që ky draft plan i punës së Kuvendit nuk është i mirë. Sepse në këtë plan për herë të barë përfshihen disa rregullore disa informata dhe disa raporte, që nuk kanë ekzistuar në planet e viteve të kaluara. Pra do ta mbështesim. Ne si grup i kuvendarëve të Nismës mendojmë që pa këto raporte të cilat i ceka më lartë, mendojmë që puna e Kuvendit do të ishte paksa e zbehtë.

Kryesuesi: Pajtohem plotësisht, jo të gjitha raportet, apo ato që janë obligime ligjore janë përfshi këtu. Nëse doni ne mund ti përfshimë me propozime konkrete. Veç se duhet të caktojmë muajin. Po këtu e kemi pothuaj në secilin muaj mbulesë, kërkesa dhe sugjerime nga ekzekutivi po, pse jo edhe nga Kuvendi. Siç e tha edhe parafolësi z. Hodaj, ky plan është fleksibil, mund ta ndryshojmë varësisht prej nevojës. Mund të heqim ndonjë pikë nga muaj në muaj, mund të shtojmë diçka. Mirëpo, pajtohem plotësisht që raporti financiar i këtyre organizatave që kanë përfituar nga subvencionet duhet të përfshihen. Duhet të përfshihet raporti i këtyre këshillave për trashëgimi kulturore që janë obligime ligjore gjithashtu. Duhet të përfshihen rregullore të ndryshme të drejtorive, por të cilat nuk i kanë pas gati dhe i kemi lënë mundësi që ato të propozojnë sipas procedurës së rregullt. Nëse doni po i përfshim tash, apo po lemë mundësinë që ato me ardhur si kërkesa të kuvendit në pika të ndryshme të rendit të ditës. A ka dikush diçka tjetër të shtoj rreth kësaj? Nëse jo atëherë po e hedhim në votim. 35 anëtarë janë prezentë në sallë, kush është për?

Për? – Të gjithë.

Kundër? – S’ka.

Abstenime? – S’ka.

Atëherë konstatoj se unanimisht me 35 vota miratohet Plani i punës të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, për vitin 2018.

Pika e pestë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozimvendimit për bartjen e mjeteve të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2016 dhe 2017, në vitin 2018

Për këtë pikë të rendit të ditës ftoj përfaqësuesin nga Financat që të jap sqarime.

Zenel Ahmetaj, përfaqësues i Drejtorisë për Financa: Sot para jush është në dokument i cili është praktikë për çdo vit. Për shkak se dihet për çdo vit të hyrat vetanake që mbliidhen nga Kuvendi i komunës, nuk mund të

shpenzohen për arsye të ndryshme. Për shkak se edhe është në muajit e fundit, edhe inkasimi bëhet deri më datën 31.12. Kështu që është e pamundur për shkak se i mbyllim të gjitha datat e nevojshme për zotime dhe shpenzime. Prandaj, në komunën e Prizrenit më datë 31.12. ka rezultuar që do të kemi mjete të pashpenzuara në vlerë prej 3.219.709 € Nga kjo shumë mjetet që kanë mbet pa shpenzua nga viti 2016. Është edhe një shumë që ka mbet pa shpenzua në një vlerë prej 218.805 € Dhe pjesa tjetër nga të hyrat e rregullta vetanake të vitit 2017, në vlerë prej 3.010.903 € Që gjithsejtë janë në shumën e mëparshme 3.219.709 € Ne gjatë kësaj periudhe jemi konsultuar me të gjithë drejtorët, duke i marrë parasysh kërkesat dhe obligimet e tyre, në mënyrë që me këtë shumë të pashpenzuar të mund ti mbulojmë edhe obligimet dhe nevojat e drejtorive në përgjithësi. Duke u bazuar në kategoritë ekonomike. Po e theksoj në kategoritë ekonomike për shkak se i tërë buxheti alokohet në pesë kategori. Do më thënë në kategorinë e pagave dhe mëditjeve. Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Shërbimeve komunale. Subvencioneve dhe të investimeve kapitale. Ne gjatë gjithë diskutimeve me drejtorë dhe me zyrtarë tjerë, menaxher nëpër drejtori, kemi arritur në përfundim që komuna e Prizrenit ka nevojë për këtë shumë të mjeteve nëpër këto kategori. Të cilat duhet të kërkohen të bartën. Ne kemi kërkuar në kategorinë e pagave dhe mëditjeve në një vlerë prej 111.626 € Do të thotë nga kjo shumë 10.455 € janë në Drejtorinë e Shëndetësisë Primare, që realisht janë edhe mjete të tyre gjatë inkasimit. Dhe pjesa tjetër në vlerë prej 101.171 € për Drejtorinë e Arsimit, një pjesë për arsim fillor dhe një pjesë për arsimin e mesëm. Gjithashtu nga kjo shumë ne kemi kërkuar që të bëhet bartja edhe në vlerë prej 567.046 € që e kemi në material në faqen 3 apo 4. Sipas drejtorive, në shërbimet komunale kemi paraparë në një vlerë prej 63.763 € Në subvencione kemi planifikuar sipas kërkesave në vlerë prej 138.732 € Dhe pjesa tjetër prej 2.348.542 € në kategorinë e investimeve apo të projekteve kapitale. Mirëpo, gjatë kësaj periudhe para nja tri, katër dite, kemi marrë një kërkesë nga Ministria e Financave që të ndodh një ndryshim në kuadër të kategorive ekonomike. Unë po ju informoj që kemi ndryshim në kategorinë e mallrave dhe të shërbimeve për shkak se kemi kërkuar një shumë rreth 97.000 € më tepër se që duhet realisht. Për shkak se kanë qenë edhe alokimet dhe planifikimet në shumën e caktuar. Mirëpo, ne për shkak të nevojave e kemi rritë këtë kategori për 97.000 € Kështu që na është kërkuar realisht të e zbrisim. Dhe në anën tjetër të rrisim kategorinë e shërbimeve komunale, që ne e kemi paraparë, nuk kemi nevojë. Po për shkak se procedurat e sistemit nuk lejon të bëhet rritja, përveç se aq sa ka qenë e lejuar me planifikim dhe alokim. Do të thotë të rritet për 100.000 € Dhe subvencionet të zvogëlohen nga 138.000 € në vlerë 70.884 € Që realisht, pa me na i dëmtuar kërkesat tona në këto tri kategori. Dhe realisht këto ndryshime, rezulton që ne në investime kapitale do të

kemi një rritje për 64.000 € Prandaj duke u bazuar në kërkesën e Ministrisë së Financave që ata na kanë thënë që nëse nuk i bini me kërkesa që i njeh sistemi. Atëherë keni me pas telashe edhe me alokim. Prandaj, unë kërkoj nga ju që të merret parasysh kjo kërkesë e Ministrisë së Financave, pasi që pas kësaj periudhe të bëhet bartja ashtu qysh kanë kërkuar. Ne mund të bëjmë kërkesë për transfer, nga shërbimet komunale. Do më thënë ti rritmi në kategorinë e mallrave dhe anasjelltas, të rritim kategorinë e subvencioneve për kategorinë e nevojshme. Kjo ishte ne pika të shkurta.

Kryesuesi: A ka dikush që dëshiron ta marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës?

Alush Shala: Nuk e di cili nga përfaqësuesit e popullit do të pranonte ti humbiste këto mjete qoftë edhe për një muaj, se le për një vit. Po unë mendoj që ka qenë e drejta e juaj që këtë shumë ta paraqitni më herët para kuvendarëve. Dhe ridestnimi i këtyre mjeteve ta kishte marrë pëlqimin edhe sugjerimin që do të kishte dal prej kuvendarëve që janë prezent të asamblesë. Unë do të abstenoj, vetëm për një arsye, sepse kur është paraparë ndarja, ridestnimi i këtyre mjeteve, nuk është paraparë për projektin Karitas, i cili përfshinë 78 persona, apo më mirë më thënë 78 familje. Është mundua edhe drejtori me na dhënë sqarimin në mbledhjen e KPF-së. Po këto nuk janë paga dhe këta kanë mund me hy te mallrat dhe shërbime. Besoj që një pjesë sa e vogël i takon komunës në këtë kategori pagesash. Mendoj se ka pas sa të duash vend, mu realizua ky projekt dhe me qenë sikurse 12 komunat e Kosovës që po e vazhdojnë projektin.

Lirije Bytyqi (Nisma): Grupi i kuvendarëve Nisma Socialdemokrate do ta mbështes dhe do ta votoj për propozimvendimin për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake nga viti 2016, 2017 në vitin 2018. Urojmë që viti 2018 dhe vitet në vijim komuna e Prizrenit të mos e trashëgoj mbetjen dhe bartjen e të hyrave vetanake. Kërkojmë nga kryetari dhe ekzekutivi që të jenë më efikas në punë. Dhe të ju përgjigjen nevojave të qytetarëve në mënyrë që të shfrytëzohen mjetet me kohë. Dhe të mos jemi më të detyruar të bëjmë bartjen nga viti në vit.

Simir Krasniqi: Unë dua të lidhem me pyetjen e bacit Alush, ku tha që ne sot do të bëjmë bartjen e mjeteve nga viti 2016 dhe 2017, 3.200.000 € Do të ishte mirë që edhe kryetari të ishte këtu prezent që kur të del me deklarata të ndryshme. Jo komuna e Prizrenit, qeverisja e kaluar më ka lënë borxhe njëherë 130.000 € mandej 3.000.000 € Ku nuk po del që 3.200.000 € mbetje mbesin dhe bartën në vitin 2018. Bartja që është bërë, edhe kjo do të ishte një e mirë që sot 78 punëtor të Karitasit të largohen të qiten në rrugë. Nuk është që dihet ajo që kontrata ka mbaruar, por disponimi i Ministrisë së Shëndetësisë, të Ministrisë

së Punës, është që të vazhdohet. Por shihet që nuk është një disponim nga ana e juaj dhe e kryetarit, që t'ia vazhdon atyre 74 infermiereve dhe 4 mjekëve të cilët punojnë me kontratë nga Karitasi. Dhe ku sot e shohim që bëhet një bartje 3.200.000 € mundësia do të ishte shumë e lehtë që të ndahen, aty po më duket 25.000 € ishte drejtor pagat për çdo muaj. Një shumë prej 300.000 € me një disponim të mirë. Ne do të bëjmë që 78 familje që ta vazhdojnë punën, e jo ti qesim në rrugë. Keni ardhur me atë qëllim që ne do ta zbusim papunësinë. Po shihet çfarë zbutje e papunësisë, në starte 78 familje qiten në rrugë. Ne nuk e përkrahim, pra, nuk do ta votojmë.

Illir Baldedaj: Grupi i kuvendarëve të AAK-së do ta mbështet këtë pikë të rendit të ditës, sepse është në interesin e qytetarëve që mjetet ti rikthehen qytetarëve dhe të kryhen punimet në të cilat ka pas ngecje në mungesë të buxhetit. Por ka qenë mirë që drejtori i Financave të del dhe të na sqaron. A kishim mundur që edhe me juve të pushtetit edhe si opozitë me gjet një konsensus për pikën që po diskutohet, sepse vërtetë mjekësia duhet të ketë prioritet edhe në qeverisjen e juaj. Është mirë që ata mjek dhe atyre punëtorëve t'u sigurohen mjete. Nuk ka projekt të parëndësishëm aty, për derisa i keni planifikuar ti qoni mjetet. Mirëpo të bëhet nga një zvogëlim i vogël dhe të gjenden mundësit deri në rishqyrtim të buxhetit në qershor.

Kryesuesi: Dikush tjetër? Nëse nuk ka, atëherë e konstatoj kuorumin, 36 anëtarë janë prezent në sallë. Dhe këtë propozimvendim për bartjen e mjeteve, me kërkesën e Ministrisë për disa ndryshime në kode që ka bo, e hedh në votim.

Kush është për? – 23.

Kundër? – S'ka.

Abstenim? - 12.

Atëherë me 23 vota për dhe 12 abstenime, aprovohet propozimvendimi për bartjen e mjeteve të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2016 dhe 2017, në vitin 2018.

Pika e gjashtë:

Shqyrtimi i Raportit të Realizimit të Buxhetit Komunal i vitit 2017.

Ftoj drejtorin e Financave që të bënë prezantimin dhe sqarimin para Kuvendit.

Ertan Simitçi drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa: Unë sot do të foli në gjuhën turke për shkak se në gjuhën turke jam përgatit, përkthimi është, materialin e keni në gjuhën shqipe. Sn. Meclis Ba kanı, Sn. Belediye Ba kan Yrd., Sn. Meclis Ba kan Yrd., de erli müdürler, de erli meclis üyeleri Prizren Belediyesi 2017 yılı bütçe raporunun hem üç dilde Arnavutça, Bo nakça

ve Türkçe hemde analizli daha kapsamlı kıyaslamalı bir ekilde müdürlü ümüz tarafından hazırlanmı tır. Raporda özellikle genel gelirler, öz kaynaklar, harcamalar müdürlüklere göre gelir ve giderlerin tabloları, sübvansiyon giderleri, yatırım sermayeleri, mali yükümlülükler yer almaktadır. Bildi iniz üzere belediyelerin bütçeleri iki kapsamda olu maktadır bir merkezi bütçe ve iki yerel bütçe. Prizren Belediyesi 2017 yılında merkezi bütçeden 31.945.642 de erinde bir tutar tahsil etmi tir. Bu tutarın %100 yıl sonuna kadar gerçekleştirilmi tir. Prizren Belediyesi, öz kaynakları toplamında planlanan bütçeye göre 7.1 milyon yuro de erinde bir gelir elde etmi tir. Ancak planlanan bütçede 6.1 miyondur ve yakla ık 1.1 milyon yuroluk bir artı görölmektedir. 2010 yılından elde edilen gelirlerin 1.7 milyon ya da yakla ık 1.8 milyon yuroluk bir gelirden 2018 yılının bütçesine aktarılacaktır. Halkın katılımı ve yerel ba ı lar yakla ık 200 bin yuro iken 83.697 yuroluk ta bir harcama yapılmı tır. Dı ba ı tan elde edilen gelirler yakla ık 50 bin yuro iken 14.510 yuro civarında da bir harcama yapılmı tır. Sonuç olarak 2017 yılın sonuna kadar Prizren Belediyesinde tahsis edilen tutar 40. 147. 379 yuro iken bu tutardan 36. 7 milyon yuroluk bir harcama yapılmı tır veya %91 oranında bir gerçekleştirilme olmu tur. Prizren Belediyesinin öz kaynakları elde edilen gelirlerin sıralamasına göre in aat ruhsatları %264, kadastro ve jeodezi hizmetleri %131, remi evraklara eri me %135, emlak vergisi %107, araç vergileri %121 oranında artı göstermi tir. En fazla paya sahip olan %29 ile emlak vergisi ve %16 ile çöp i letmelerinde elde edilen gelirlerdir. 2016 yılı ile bir kıyasalama yaptığımızda %13.4 oranında da bir artı görölmektedir. Ki Prizren Belediyesi 2017 yılından bugüne kadar ilk defa öz gelirlerde planlama üzerine çıkmı tır. 2017 Belediye bütçe giderleri ve harcamaları maa lar %99 oranında gerçekleştirilmi tir, mal ve hizmetler %78 oranında, sübvansiyonlar %96, belediye hizmetleri veya kamu harcamaları %80, sermaye yatırımları %86 oranında bir harcama olmu tur. Toplamda Prizren Belediyesinin 2017 yılı bütçe giderleri 36.7 milyon yurodur. Planlamaya göre 3.9 milyon yuroluk bir durum bulunmaktadır ve %92 oranında bir gerçekleştirilme göstermi tir. Kısaca belirtmek isterim ki Prizren Belediyesi 2017 yılında üç tane ana sorun ile kar ıla mı tır. Birincisi Maliye Bakanlı ının Belediyelere yönelik yapmı oldu u mal ve hizmetler bölümündeki alt kodlardan çıkan sorunlar, bütçe yorumlanması veya Rishikimi i buxhetit Kosova Meclisi tarafından onaylanmaması, ihale süreçleri ve bu süreçlerde meydana gelen itirazlar, ister istemez bu üç tane önemli olay Prizren Belediyesini veya Kosovadaki birçok belediyenin bütçe giderlerinde sıkıntı veya sorun te kil etmi tir. Bu rapor Maliye Müdürlü ümüz tarafından effaf veya kapsayıcı bir ekilde hazırlanmı tır, 2016 bütçe raporunu G Z kurumu tarafında yapılan ara tırmalar sonucunda Prizren Belediyesi Kosovada en effaf belediye olarak seçilmi tir. Bu yıl da amacımız tüm gelir ve giderleri

en effaf ekilde hem meclis üyelerimize hem de vatanda larımızın huzuruna sunmaktır. Son olarak Belediyenin finans yükümlükleri, belediyeye kar ı olan yükümlülükler toplam 17.1 milyon yurodur. Prizren Belediyesinin ödememi oldu u yükümlülükler ise yakla ık 3.8 milyon yurodur. Di er bütün detaylar ve bilgiler raporda sunulmu tur sorunuz varsa veya öneriniz varsa cevaplamaya hazırız te ekkürler.

Raporti i buxhetit të vitit 2017 të Komunës së Prizrenit është përgatitur në mënyrë të analizuar, gjithëpërfshirëse dhe krahasuese në tri gjuhë si shqip, boshnakisht dhe turqisht nga ana e drejtorisë tonë. Në këtë raport marrin pjesë të ardhurat e përgjithshme, të hyrat vetanake, tabelat e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas drejtorive, shpenzimet e subvancioneve, investimet kapitale dhe detyrimet financiare. Siç e dini buxheti i komunave përbëhet nga ato qëndrore dhe lokale. Komuna e Prizrenit në vitin 2017 nga buxheti qëndror ka alokuar në vlerë 31.945.642. Nga kjo vlerë deri në fund të vitit 100% është realizuar. Komuna e Prizrenit sipas buxhetit të planifikuar nga gjithsej të ardhurat vetanake ka fituar në vlerë 7.1 milion euro. Por buxheti i planifikuar është 6.1 milion dhe ka rritje rreth 1.1 milion euro. Të ardhurat 1.7 milion ose rreth 1.8 milion euro nga viti 2010 do të transferohen në buxhetin e vitit 2018. Pjesëmarrja e popullit dhe donacionet vendore janë rreth 200 mij euro dhe nga këto janë shpenzuar 83.697 euro. Të ardhurat nga donacionet e jashtme janë rreth 50 mij euro dhe nga këto janë shpenzuar përafërsisht 14.510 euro. Si rezultat i kësaj në Komunën e Prizrenit vlera e alokuar deri në fund të vitit 2017 ka qenë 40.147.379 euro dhe nga këto janë shpenzuar 36.7 milion euro ose 91%. Sipas renditjes së ardhurave të fituara nga të hyrat vetanake të Komunës së Prizrenit kanë pasur rritje si në vijim: lejet ndërtimore 264%, shërbimet kadastrale dhe gjeodezisë 131%, qasje në dokumente zyrtare 135%, tatimi mbi pronë 107%, tatimet e automjeteve 121%. Pjesën më të madhe të hyrave e ka tatimi mbi pronë me 29% dhe shërbimet e mbeturinave me 16%. Kur bëjmë një krahasim me vitin 2016 vrehet një rritje me 13.4 %. Komuna e Prizrenit nga viti 2017 deri më tani për herë të parë ka tejkaluar planifikimin në të hyrat vetanake. Shenzimet buxhetore të Komunës në vitin 2017 pagat 99 % janë realizuar, mallrat dhe shërbimet 78%, subvencionet 96%, shërbimet komunale ose shpenzimet publike 80%, investimet kapitale 86% janë shpenzuar. Gjithsej shpenzimet buxhetore të vitit 2017 të Komunës së Prizrenit janë 36.7 milion euro. Sipas planifikimit është një gjendje 3.9 milion euro dhe 92% është realizuar. Do të doja të përmendja shkurtimisht se Komuna e Prizrenit në vitin 2017 është përballur me tri probleme kryesore. Nga këto e para është problemet e dala nga Ministria e Financave ndaj komunave në nën kodet në pjesën e

mallrave dhe shërbimeve, mos miratimi i rishikimit të buxhetit nga ana e Kuvendit të Kosovës, procedurat e tenderimit dhe kundërshtimet e shfaqura në këtë proces. Këto tri ngjarje të rëndësishme kanë shkaktuar probleme në Komunën e Prizrenit dhe në shumë komuna të Kosovës. Raporti në fjalë është përgatitur në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse nga drejtoria jonë. Si rezultat i hulumtimeve të bëra në raportin buxhetor të vitit 2016 nga ana GIZ-it, komuna e Prizrenit është zgjedhur komunë më transparente në Kosovë. Synimi jonë është që edhe në këtë vit si në praninë e anëtarëve të kuvendit ashtu edhe në praninë e qytetarëve të gjitha të hyrat dhe të dalurat ti'a sjellim në mënyrë transparente. Së fundi detyrimet financiare të Komunës, detyrimet ndaj komunës janë gjithsej 17.1 milion euro. Detyrimet e Komunës së Prizrenit të papaguara janë rreth 3.8 milion euro. Të gjitha detajet dhe të dhënat tjera mund ti gjeni në raport. Nëse keni ndonjë pyetje ose sugjerime jemi të gatshëm për t'iu përgjigjur.

Fatmir Kastrati (AAK): Kryesues nuk kam asgjë të shtoj rreth buxhetit. Po kjo këmbëngulësia e këtij drejtori, po më duket pak e tepruar. Unë jam prej vitit 2007 në këtë Kuvend, edhe asnjëherë nuk e kemi bërë problem se në çfarë gjuhe flitet këtu. Edhe nuk e kuptoj pse këmbëngulësia e tij që të mos flet në gjuhën shqipe. Jo se po dojmë me fol në gjuhën shqip, por për shkak të pengesave teknike. Ose kryesues, unë kisha thënë që mbylle Kuvendin, deri sa të sigurohen kushtet, në mënyrë që të jemi të suksesshëm në punën tonë. Kjo po më duket jashtë rregullave të Kuvendit. Kjo është diçka politike, sa e kuptoj unë këtu. Po më duket e ka keq interpretua edhe e ka keqkuptua drejtori. Në qoftë se vazhdon me këtë këmbëngulësi. Ka edhe kërkesa tjera ndoshta që do të shtrohen në këtë Kuvend. Prandaj të jemi vëllazëror njëri me tjetrin, ta kuptojmë njëri tjetrin. Edhe kjo këmbëngulësi edhe njëherë po them është me qëllime të caktuara. Kur ne i kemi përpara këto edhe nuk na punojnë. Unë atë çka foli drejtori absolutisht nuk e kam kuptua. Më vjen keq që nuk e di gjuhën turke, kam dëshirë me e ditë. Edhe krejt është e pakuptimtë kjo çka ka ndodh.

Shukri Quni: Nuk bënë kjo të ndodh fare. Ne e dimë edhe kur është hekë viti 1878 i Lidhjes së Prizrenit. A e dinë Artan të. Edhe ke pas dal e ke protestuar para derës pse po e hiqni. Tri herë nëse nuk gaboi, të përmirëson Hazizi që e kemi votuar ne 2/3. Në rast se i pengon dikujt kjo, duhet me na tregua edhe neve. Edhe ne kërkojmë me u kthye tash, pasi je ti kryesues me kthye vitin 1878 në Lidhjen e Prizrenit. E qetë në votim edhe ne e votojmë.

Kryesuesi: Po dalim jashtë pikës së rendit të ditës. Po, në qoftë se garantoni që grupi parlamentar i PDK-së në Kuvend të Kosovës, kërkon ndryshime Kushtetuese. Të hiqen dispozitat e Marti Ahtisarit, të cilat kanë

vendos si pengesa, ku shkelet vullneti i qytetarëve të Prizrenit dhe të Kosovës. Unë e kthej.

Alush Shala: Unë këtë pyetje, këtë kërkesën tënde z. Kryesues që e bëre, që t'ia bëjmë anëtarëve të Parlamentetit të Kosovës. Unë mendoj që çdo gjë duhet të filloj nga baza. Problemi është, se ne nuk i mësojmë deputetet. Por nëse del një vullnet ose një vendim nga kjo asamble. A e respektojnë ata a se respektojnë, le të mbetet në ndërgjegjen e tyre. Po ndoshta ju keni qenë njeri më i dashur tek qytetarët, për shkak të këmbënguljes të një kërkesë të drejtë. Edhe nuk di a ke dëgjua nga dikush që ka thënë e ka pas gabim. Mirë është që në seancën e ardhshme ta merrni parasysh, duhet të jetë një pikë e veçantë, për këtë temë. Por unë po dua më fol edhe diçka. Z. Ertan Simitçiu, ti e dinë që ke një respekt nga të gjithë anëtarët e Kuvendit. Jo vetëm nga këtu që janë këta, por edhe ata që kanë qenë, që s'janë në këtë seancë. Mendoj që juve nuk ju shërben një armiqësi, apo një inat ta zbatoni para 41 anëtarëve të Kuvendit. Kur ju e dini që vetëm dy turqjeni. Edhe duhet të jetë në krenarin tënde që ti e dinë për një gjuhë je më i pasur se ne, që se dimë gjuhen turke. Ti duhet mu ndie mjaftë i kënaqur që e njuh gjuhen. Përndryshe z. Artan, nëse ju mendoni me injorua me inate të individëve, qoftë e një individit. Po të them, neve na lid e drejta me procedura pak më shumë. Andaj z. Kryesues, ose rregulloj këto përkthyeset. Nuk na intereson neve a bëjnë 70.000 a 80.000 €, se ne nuk i rregullojmë. Nuk e ka bërë ai kryesuesi i jonë, që gjithmonë edhe ju keni qenë prezent, që gjithmonë ka pas kritikë edhe unë edhe ata tjerët. Po ju them nuk është mirë me shti përçarje, se qeto fjalët tona po i merr komuna e Prizrenit. Andaj ne nuk kemi me popullin apo me komunitetin turk asgjë. Por nuk e di pse sot u hidhërua z. Ertan, edhe e bëri këtë punë, që mendoj nuk i ka pas hije.

Kryesuesi: Veç një sqarim të shkurt si anëtarë i këtij Kuvendi edhe në mandatin e kaluar mund të them vetëm diçka. Ky Kuvend ka, ka pas dhe do të ketë mospajtime politike, për atë në çka është i thurur në funksione dhe kompetencë të vetë. Po ky Kuvend nuk ka përçarje, as nuk do të ketë asnjëherë. Së paku jo për aq sa unë i drejtoj mbledhjet. Mund të ketë keqkuptime. Po nuk besoj të jenë të vullnetit të keq, pavarësisht nga kush. Problemet politike kanë qenë janë dhe do të vazhdojnë të jenë. Janë rrjedhojë e një sistemi demokratik. Dhe se nuk e shoh aq tragjike, sa edhe aq po bëhet. Prandaj unë nuk ju kisha kushtuar shumë rëndësi kësaj çështje. Vazhdojmë rreth pikës së rendit të ditës, rreth realizimit të buxhetit. Edhe njëherë ju kisha lutur të përqendrohemi rreth realizimit të buxhetit.

Ilir Baldedaj: Me gjithë respektin për ish kolegut tim Ertan Simitçiu. Vërtetë kemi qenë kolegë. Por kjo formë, ose ti kryesues obligohu, thirri

përkthyesit që i ke brenda. Gjatë çdo fjalie le ta përkthejnë në gjuhën shqipe dhe në gjuhën boshnjake. Ose mos lejo që me gjithë respektin për komunitetin turk, për dy kolegët edhe për Sencarin edhe për Ertanin. Vërtetë ka qenë fyerje për ne si shumicë. Sepse ne asnjëherë nuk ua kemi ndalua të flasin. Ky Kuvend ka marrë vendim të jetë gjuhë zyrtare gjuha turke. Andaj nuk është mirë, as për Ertanin, nuk i bënë nderë as Ertanit. Duke e ditur se e dinë gjuhën shqipe me fol në gjuhën turke për çështje inati. Nëse drejtori ka çështje inati. Çështjet e inatit drejtor i jashtë orarit të punës, dhe jo në detyrë zyrtare. Sepse këtu je zyrtarisht drejtor i Financave dhe je drejtor i të gjithë qytetarëve të komunës së Prizrenit. Nuk je drejtor vetëm i komunitetit turk. Andaj tu kisha lutur për shkak të respektit dhe e ke obligim moral tu kërkosh falje qytetarëve të Prizrenit, që janë të përkatësisë shqipe. Sepse vërtetë nuk të kanë marrë vesh asgjë çka ke thënë.

Kryesuesi: A ka dikush tjetër diçka të shtoj? Nëse jo 35 anëtarë të Kuvendit janë në sallë, e hedh në votim, kush është për?

Për? – 28.

Kundër? – 2.

Abstenim? – 5.

Atëherë konstatoj se me 28 për, 2 kundër dhe 5 abstenime miratohet Raporti i Realizimit të Buxhetit Komunal i vitit 2017.

Pik e shtatë:

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për Transparencë në Komunë, për vitin 2018

Kryesuesi: Ftoj zyrtarin për transparencë të komunës që ta bëjë prezantimin para Kuvendit.

Ymer Berisha, zyrtarë për transparencë: Plani i veprimit për transparencë për vitin 2018, kujdesshëm dhe profesionalisht ka konsultuar metodat më të avancuara të komunikimit. Në këtë hov të zhvillimit të teknologjisë edhe trurit në përgjithësi. Jetësimi dhe zbatimi i planit të veprimit përfaqëson praktikë të avancuar politika publike komunale dhe përkushtim të lidërsipit politik udhëheqës. Me synim konsolidimin e shoqërisë sonë në Prizren. Me vlera të mirëfillta civilizuese demokratike. Kujdesshëm dhe cilësisht ruajnë kujdesin për të gjithë qytetarët pa dallim teknik, fetar, race, politike e të tjerë. Jemi institucioni më i lartë administrativ, politikë dhe vendimmarrës. Ndaj edhe shërbimet, vendimet dhe gjithçka tjetër që lidhet në këtë drejtim, duhet ta kemi në fokus kryesor qytetarin dhe interesin e tij. Transparenca. Parimi transparencës bazohet në informimin e qytetarëve me

aktivitetet e komunës, në kohën e duhur, dhe përmes mjeteve adekuate, të komunikimit. Politikë kjo publike, e cila synohet gjithnjë e gjithmonë e arrirë asnjëherë. Po e ritheksoj, transparencë në asnjë institucion vendor e ndërkombëtar edhe në Amerikë nuk arrihet në asnjë moment të caktuar. Është e dëshirueshme që të vazhdojmë. Por nuk guxojmë të ndalemi së reshturi, që të gjithë bashkë dhe permanent të angazhohemi për politikën transparente, vendimmarrëse. Llogaridhënia e planit të veprimit për transparencë. Udhëheqës të gatshëm për të marrë përgjegjësitë dhe obligimet e veta publike institucionale. Edhe atëherë kur mund të kenë pasoja. Lidhshipi i komunës së Prizrenit duhet të reflektoj, madje edhe Kuvendi duhet të reflektoj përgjegjshmëri, që edhe kur ka pasoja, të jemi të gatshëm të marrim konsekuencat e tyre. Përgjegjshmëria si kriter tjetër, komunikim i rregullt i autoriteteve me qytetarët siguron shkallë të lartë të përgjegjshmërisë përballë premtimeve, arritjeve të sukseseve, por edhe dështimeve eventuale. Përgjegjshmëria është akt i lartë moral, sa do të jemi në gjendje ta jetësojmë, pritet me u pa gjatë viteve në vijim. Gjithë përfshirja. Përmes zbatimit të parimit të gjithë përfshirjes në komunikim, komuna siguron informim të drejtë me kohë për të gjithë qytetarët. Komunitetin e biznesit, komunitetin kulturorë, organizatat e shoqërisë civile, mediat edhe grupet tjera të interesit. Shumëllojshmëria. Përmes këtij parimi nënkuptohet shfrytëzimi i a më shumë mjeteve dhe formave të informimit dhe komunikimit, duke përfshirë televizionet, radiot, gazetatat, portalet elektronike, ueb faqen e komunës, rrjetet sociale, programet ose aplikacionet specifike të komunës, sistemet androide e kështu me radhë. Informimi me kohë. Me këtë nënkuptojmë që komuna duhet të jetë aktive në informimin e qytetarëve në lidhje me vendimet, aktivitetet dhe planet e sajë. Në mënyrë që qytetarët nga ana e tyre të jenë në gjendje të veprojnë në përputhje me informacionin e pranuar nga ana e komunës së Prizrenit. Informatat kthyesë. Përmes zbatimit të sajë, nënkuptojmë ofrimin e mundësive qytetarëve që ti japim komentet, rekomandimet apo vërejtjet e tyre. Kjo i mundëson komunës që të ndër marrë veprime konkrete në përputhje me kërkesat e qytetarëve. Më qëllim të përmirësimit të performancës së komunës në këtë rast. Vizioni i planit të veprimit për transparencë dhe zyrës që udhëheqë është, qytetarë të informuar, mekanizma efikas të komunikimit dhe të pjesëmarrjes. Duke bërë kështu komunën e Prizrenit të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse ndaj qytetarëve të sajë. Të nderuar kuvendarë, duke e vlerësuar lartë punën dhe angazhimet tuaja. Kërkoj nga ju të gjithë që solemnisht dhe unanimisht, ta votoni këtë Plan të veprimit për transparencë për komunën tonë për vitin 2018. Dhe në këtë mënyrë, të tregojmë para qytetarëve se komuna e Prizrenit megjithatë është lidhshipe në implementimin e politikave

publike në dobi të qytetarëve të komunës së Prizrenit. Na shkoftë mbarë, faleminderit.

Kryesuesi: Faleminderit z. Berisha për këtë prezantim të mrekullueshëm të Planit për transparencë. Më të vërtetë i keni munguar këtij Kuvendi dhe se ju falënderoj për këtë veprim. Kush e donë fjalën për Planin e veprimit për transparencë?

Fatmir Kastrati: Kryesues ne e kemi marrë në formë të shkruar. Po edhe pas këtij prezantimi të Ymerit, nuk e di a kemi arsye me kundërshtua. Edhe po më vjen mirë që paska vazhdua punën e zëdhënësit të komunës edhe më tutje. Unë mendoj se ky plan i transparencës është i mirë. Mirëpo, vërtetë duhet ju si kryesues, po edhe të gjithë ne ti rrimë gati se a po zbatohet në praktikë apo nuk po zbatohet në praktikë. Ne letrat po i bëjmë shumë mirë, dokumentet po i përgatisim jashtëzakonisht mirë, se po kemi mundësi teknike me bo një gjë të tillë. Mirëpo, po në praktikë pastaj po kemi shumë ngecje. Prandaj tu kisha lutë, po mendoj ju si kryesues, që ta përcillni, ta monitoroni gjithë këtë që është e shkruar, në mënyrë që të jetë edhe praktikë e suksesshme.

Shukri Quni: Parashtrori pyetje se çfarë pune është duke e kryer z. Ymer Berisha. Më habit fakti se si nuk e keni larguar. Me pas qenë unë këtu, as në oborr të komunës nuk e kisha lanë, çka ju ka bëra ai juve. Po pasi që tha ani me votua, do ta votojmë të gjithë.

Kryesuesi: LVV-je, nuk është subjekt politikë hakmarrës. Të gjithë shërbyesit civil të cilët punojnë me profesionalizëm, i kryejnë detyrat e tyre, janë korrekt dhe objektiv në punën e tyre, natyrisht se do të vazhdojnë punën e tyre. Dhe padyshim njëri ndër ta shpresoj të jetë edhe z. Berisha.

Haziz Hodaj: E falënderoi Ymerin për punën që ka bërë, se askush ma zor nuk ka qenë gjatë mandatit të qeverisjes së PDK-së. Që ti kthej në pozitat e veta edhe ato që kanë qenë jashtëzakonisht të rënda mi kthye. Mirëpo ai me elegancën e vetë, me finesat e veta, sikurse kjo fjala sot. Ka qenë brilant gjithmonë në zëdhënien për komunën. Kështu që do ta votojë me dy duart natyrisht, duke kërkuar që ky plan, ky projekt për transparencën të implementohet. Sepse transparenca është më së shumti ajo ja shkurton këmbët edhe keqqeverisjes edhe keqpërdorimit edhe korrupsionit edhe të gjitha. Andaj ta votojmë edhe ta implementojmë bashkërisht.

Ilir Baldedaj: Grupi i AAK-së do ta mbështet këtë pikë të rendit të ditës. Por a po sheh që nga ish pushteti, e kemi lënë kokë të mençur që po ju jep mend edhe juve. Kështu që mos shihni krejt zi, sepse mos të kishte qenë Ymeri me lexua, problem ju krejt mu pas qua me lexua këtë çka e tha Ymeri. Po Ymeri, e

tha Haziz, e ka pas barrën e rëndë, po qetash e ka më të rëndë. Sepse edhe në atë kohë është punua ndoshta, po mirë e keq është punua. Këtu tash s'është kah punohet kurrgjë, edhe është problem çka po donë me thënë.

Alush Shala: Unë s'do të flas për Ymerin, sepse ai e ka bërë punën e vet. Por po flasim për transparencë. Se vërtet gjithmonë sipas Ymerit është që lënë për të dëshiruar atë që bëjmë. Unë e kam parasysh këto pesë muaj që i kaluam, që nuk ka pas fare transparencë për opinionin por edhe pse jo edhe për neve. Nuk e di që deri më tani a është përdorë ky facebook. Por unë mendoj që facebook është i vetmi për të cilin mund të informohen të gjithë qytetarët e Prizrenit. Edhe unë do ta mbështes, mirëpo kërkoi që të implementohet kjo transparencë, duke filluar nga kryetari e deri të kuvendari që është me i thjeshti për komunën.

Lirije Bytyqi: Plani i veprimit për transparencë në komunë është një dokument i rëndësisë së veçantë. Andaj ne kuvendaret e Nismës Socialdemokrate duke e parë si të tillë, e vlerësojmë si plan i mirë. Pra, do ta mbështesim do të votojmë pro. Urojmë që ky plan të zbatohet në tërësi, duke na ngritur në shkallën e vlerësimit më të lartë, se në vitet që i lamë pas.

Kryesuesi: Atëherë 35 anëtarë jemi prezent në sallë. Atëherë e hedh në votim Planin e veprimit për transparencë në komunë, për vitin 2018, kush për?

Për? – Të gjithë.

Kundër? – S'ka.

Abstenim? – S'ka.

Konstatohet se unanimisht miratohet Plani i Veprimit për Transparencë në Komunë, për vitin 2018. Duke e bërë Ymerin si figurë më përbashkuese i të gjitha subjekteve politike në Prizren.

Pika e tetë:

Shqyrtimi i propozimvendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik

Kryesuesi: Theksoi se fjala është për projektin e stadiumit që është planifikuar të ndërtohet në Zhur. Për këtë pikë të rendit të ditës ftoj drejtorin e Kulturës, i cili do ta bëjë propozimin, dhe të jap sqarime.

Ehat Oreshka: Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport: Më datë 6 shkurt 2018, është nënshkruar një marrëveshje në mes të Ministrisë së

Kulturës, Sportit dhe Kuvendit komunal, për ndërtimin e stadiumit të futbollit në Zhur. Investimet janë të përbashkëta, 500.000 € investon Ministria ndërsa 200.000 € Kuvendi komunal. Procedurat e tenderimit kanë kaluar. Mirëpo, në fund vjen që parcela kur është ndarë për ndërtimin e stadiumit, është e agjencisë së pyjeve, konkretisht e Pylltarisë. Vendi është në lokacionin Gurishte afër Vërmicës. Materialin e keni ju para vetës, edhe kopjen e planit, edhe listat poseduese për dy parcela. Është në pyetje sipërfaqja totale që është në emër të Pylltarisë, është 41725 metër katror. Neve për ndërtimin e stadiumit na duhet 17136 metër katror. Në këtë rast këtu janë dy parcela që është në emër të pylltarisë. Ne e kemi bërë matjen, që hapësira prej 17136 metër katror, është e mjaftueshme për ndërtimin e stadiumit. Kështu që kërkoj nga ju, mundësisht që të votoni këtë propozimvendim, dhe të hapim rrugë për procedurat e mëtejshme për ndërtimin e stadiumit në Zhur.

Ilir Baldedaj: Kërkoj që së pari të paraqiten shefat e grupeve parlamentare, sepse kjo ka qenë praktikë, dhe me pastaj kushdo që dëshiron në mënyrë individuale e merr fjalën.

Simir Krasniqi: Ne si grup parlamentar i PDK-së, do ta mbështesim, mirëpo kërkoj sqarime a është e njëjta parcelë. Sepse në KPF, ishte një parcelë tjetër. Si po të veproni me ato shtëpi që janë aty, apo vetëm...

Kryesuesi: Kërkoj nga drejtori që të jap sqarime për çdo gjë, aty ku duhet me pas.

Simir Krasniqi: Drejtor ishte pyetja, aty ishin 65 ari, tash na del që është 1 hektarë. Ju thatë që ka shtëpi. Qysh do ti rrënoni ato shtëpi, a do të ketë zgjidhje. Çka do të bëni me to?

Ehat Oreshka: Aty ka qenë një gabim teknik, në listën poseduese, nuk është faji ynë. Këtu janë dy parcela, parcela në hapësirë prej 41725 metra katrorë. Po brenda kësaj parcele është edhe parcela me nr. 02521-0. Atë ditë kur ishim në mbledhje thamë që është 65 ari. Do më thënë 65 ari në këtë rast është vetëm fusha e futbollit, ku do të ndërtohet. Mirëpo, me elementet përcjellëse neve na duhet 1.7 hektarë. E në këtë rast ne hapësirën e kemi aty. Tash e kemi bo matjen saktësisht. Ndërsa shtëpitë janë më larg, dhe nuk ka asnjë pengesë nga shtëpitë në atë hapësirë që kemi planifikua.

Simir Krasniqi: Ne si grup parlamentar i PDK-së do ta përkrahim, vetëm inshalla do të bëni zgjidhje, që mos të rrënohet ndonjë shtëpi.

Kryesuesi: Urojmë që Kuvendi nuk merr ndonjë vendim që ja rrëzon shtëpinë dikujt për stadion.

Shukri Quni: Në si Kuvend kur kemi marrë edhe tjera herë vendime, na i kanë kthyer mbrapsht, këtu është problemi. Këtu tash kryesues, a e kemi ne këtë fuqi që ne më marrë një vendim të tillë, edhe Pylltaria mos me lëshua prapë atë vend. Ose siç po ndodh nëpër vende tjera, që Pylltaria në mes të fshatrave po i jep pronat, dikush i quan otrina, dikush i quan mera të fshatit. Ndërsa Pylltaria ato prona po thotë, po ua jep për pesë vjet apo për sa nuk e di tash. A ka mundësi tash këtu Pylltaria me pas këtë pengesë, që ne këtë vendim po e marrim.

Ehat Oreshka: Lënda do të shkoj në Qeveri. Qeveria do ta aprovoj këtë vendim, sikurse që ndodhi edhe me stadiumin e Prishtinës. S'ka tjetër rrugë. Në diskutim me Agjencinë e Pyjeve, ata patën disa kërkesa, jo ndërrim, parcelat me qira. Kjo nuk vjen në konsiderim. Ajo pjesa tash për momentin është në emër të Pylltarisë. Me vendimin e Qeverisë, nëse bëhet, atëherë hapet procedura për ndërtimin e stadiumit.

Sulltan Badallaj: Unë mendoj se realizohet kjo, sepse është interes publik, nuk është interes privat. Mirëpo në vendim e keni një gabim procedural që është, të neni 2 thotë: Në bazë të këtij Vendimi kryetari i komunës do ta inicioj proceduarën e mëtutjeshme për ndaljen e privatizimi të kësaj paluajtshmërie nga ana e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Këtu nuk ka të bëjë Agjencioni Kosovarë i Privatizimit. Organizatat punuese Pylltaria "Sharr" Prishtinë është pronarë, i krejt pronave, jo i të gjithëve. Komunale nuk është. Po Agjencioni Pyjor i Kosovës, i menaxhon pronat. Unë po e shoh që është gabim këtu.

Ehat Oreshka: Po nuk do të paraqes problem Agjencioni i Pyjeve për këtë procedurë.

Kryesuesi: Kërkoj nga shërbimi i Kuvendit që ta shënon këtë vërejtje, ta konsulton ligjin. Dhe nëse është ashtu menjëherë ti bëjë ndryshimet e duhura.

Badallaj: Do të kujdesët thotë zyra e Kryetarit Drejtoria komunale e Arsimit. Çka Drejtoria komunale e Arsimit? Urbanizmi është në rregull, Kadastri është në rregull. Mirë është që janë përfundua procedurat, është zgjerua hapësira. Edhe shtëpi nuk prek, se e dimë ne atë vend të Zhurit mirë. Bile drejtori ka qenë menaxher i hershëm i klubit futbollistik. Në kohë kur ka qenë me renome ati klubi, bile i pari ka qenë, që e kemi ndihmuar edhe ne bizneset, e popullata. Besoj që inshallah ec mirë edhe sa më shpejt, fillojnë punimet.

Kryesuesi: Atëherë pra ishin dy kërkesa për ndryshim në nenet e propozimvendimit. Që në vend të Agjencionit Kosovarë të Privatizimit, të

vendoset titullari i pronarit. Që në këtë rast është Pylltaria “Sharri”. Dhe në nenin 3. Në vend të Drejtoria Komunale e Arsimit. Duhet të jetë Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. A ka dikush diçka tjetër të shtoj?

Alush Shala: Unë edhe në mbledhjen e KPF-së kam thënë që nuk vjen në shprehje kjo. Po ju si kryesues nuk ia vutë fortë veshin, një. E dyta këto që i tha Sulltani, nuk po dua mi përsëritë se aty u bazova. Po shihni në certifikatën e pronës, këtu figuron, që kjo parcelë është e dedikuar për fushë të sportit, qysh para pavarësisë së Kosovës, apo para çlirimit të Kosovës. Andaj, mendoj që është mirë të shfrytëzohet edhe kjo mundësi edhe ky titull që është shkrua. Se nuk është shkrua as nga ne këtu. Po kjo është shkrua më herët, me të vetmin qëllim që kjo procedurë të shpëtohet. Sepse proceset tenderuese tha që kanë kalua. Edhe nuk kemi nevojë me prolongua këtë punë. Edhe mirë është që ta shfrytëzoni edhe këtë titull sepse është aty. Është edhe mirë pasi është rrit edhe parcela nga 65 ari që ishte një gatim po e quaj teknik, në 170 ari apo. Pothuaj që është diçka e mrekullueshme, edhe është diçka që kemi me dal mirë edhe ne si Kuvend, po edhe ju si Drejtori. Nëse e realizoni natyrisht.

Kryesuesi: Atëherë duke besuar që projekti i këtij stadiumit, hapësira e përcaktuar është në përputhshmëri me projektin. Këto parcela të ndara nga zonat kadastrale, mbulojnë nevojat e projektit. Ftoj anëtarët e Kuvendit që ta votojnë këtë propozimvendim për shpalljen e interesit publik, për ndërtimin e stadiumit të qytetit. Atëherë 34 anëtarë janë në sallë, i hedh në votim këto dy parcela që u bë prezantimi, kush është për?

Për? – Të gjithë.

Kundër? – S’ka.

Abstenim? – S’ka.

Atëherë konstatoj se unanimisht me të gjithë anëtarët prezentë votohet propozimvendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik.

Të gjithë anëtarët e Kuvendit i falënderoj për pjesëmarrje në këtë seancë. Dhe mirupafshim në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit.

Përfundoi në orën 15:10.

Procesmbajtës;
Sehat Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit
Artan Abrashi

